

Raport vlerësues

PROGRESI NË ZBATIMIN E STRATEGJISË SË ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DERI NË VITIN 2025

Qershor 2026

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	7
Progresi i realizimit të objektivave strategjike	9
Objektivi I. Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit	9
Objektivi II. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme	12
Objektivi III. Rritja e efikasitetit të energjisë	18
Objektivi IV. Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut	21
Objektivi V. Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve	22
Mekanizmi i rregullimit të kufirit të karbonit (CBAM)	23
Sfidat në implementimin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031	26
Përfundim dhe rekomandime	29
Shtojca	31

Lista e shkurtesave

ALPEX	Bursa Shqiptare e Energjisë (shkëmbimi i energjisë Shqipëri–Kosovë)
BERZh	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
CBAM	Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit të Karbonit
CfD	Kontratë për Diferencë
CO₂	Dioksidi i karbonit
EECS	Sistemi Evropian i Certifikatave të Energjisë
EU ETS	Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE-së
FKEE	Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GO	Garancitë e Origjinës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribimin e Energjisë Elektrike
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
ktoe	kiloton ekuivalent naftë
MCA Kosovo	Llogaria e Sfidës së Mijëvjeçarit në Kosovë
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MW	Megavat
MWth	Megavat termik
NO_x	Oksidet e azotit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit (Shqipëri)
PPA	Marrëveshje për Blerje të Energjisë
SAIDI	Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve të sistemit
SAIFI	Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit
SO₂	Dioksidi i squfurit
SO_x	Oksidet e squfurit
WEM	Gratë në Energji dhe Miniera
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031 (Strategjia) synon dekarbonizimin dhe transformimin e sektorit energjetik drejt një sistemi më të qëndrueshëm dhe të sigurtë, në përputhje me obligimet dhe orientimin drejt politikave të BE-së për klimë dhe energji. Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i progresit të deritanishëm si dhe niveli i përmbushjes së objektivave strategjike afatshkurtra deri në vitin 2025, të përcaktuara në këtë Strategji, duke paraqitur sfidat kryesore dhe arritjet që kanë ndikuar në zbatimin e tyre.

Gjetjet kryesore tregojnë se në çështjen e dekarbonizimit dhe rritjes së kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE-ve), progresi deri në vitin 2025 mbetet i kufizuar dhe nën caqet e përcaktuara në Strategji. Kapaciteti i BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike është vetëm 8%, nën objektivin e vënë prej 13% për vitin 2024. Në periudhën 2021-2025, kapaciteti i BRE-ve është rritur për vetëm 51 MW, nga 279 MW në 330 MW, kryesisht i nxitur nga investime të vogla private. Veçanërisht, problematike mbetet dinamika jo e lartë në zbatimin dhe funksionalizimin e projekteve investive në energji të rinovueshme, ku aktualisht ka projekte me mbi 700 MW kapacitet në faza të ndryshme të zbatimit; shumica e tyre ende në fazën e proceseve administrative dhe jo të ndërtimit. Ndërkaq një trend më i mirë vërehet në rritjen e kapacitetit nga prodhuesit vetë-konsumues (prosumatorët), ku në vitin 2025 kapaciteti i instaluar ka arritur në rreth 34 MW, duke e tejkaluar cakun e ndërmjetëm të vitit 2025 prej 30 MW. Ky rezultat i atribuohet kryesisht thjeshtëzimit të rregullave të licencimit të vetë-prodhuesve por edhe procesit të liberalizimit të tregut të energjisë, që ka shërbyer si nxitje që bizneset të nisin dhe të instalojnë kapacitete nga BRE për vet-konsum.

Kjo rritje e ngadalshme e BRE-ve nuk mjafton për të arritur synimin afatgjatë të kapacitetit të prodhimit ekuivalent me 1,600 MW deri në vitin 2031. Si rrjedhojë, Kosova vazhdon të renditet e fundit në rajon dhe mbetet dukshëm prapa vendeve të tjera sa i përket kapacitetit të instaluar të BRE-ve në vitet e fundit. Po ashtu, tek konsumi i energjisë elektrike në Kosovë, presioni më i madh vije nga sektori rezidencial, tek i cili shkalla e jo-efiçencës së energjisë është e lartë. Dhe, në këtë drejtim, Strategjia ka ngecje në arritjen e caqeve rreth efiçencës të energjisë në këtë sektor.

Si dhe, përkundër afateve në Strategji, Kosova deri më tani nuk ka dizajnuar një taksë apo skemë për emetimin e karbonit brenda vendit për të penalizuar ndotësit e ambientit por edhe mundësuar që një pjesë e pagesës që eksportuesit e Kosovës tani duhet të paguajnë tani në shtetet e evropiane (taksa/mekanizmi i Bashkimit Evropian për rregullimin e kufirit të karbonit (CBAM)), të mund të ri-investojë brenda vendit.

Ndërkaq, një progres tjetër në zbatimin e Strategjisë, vërehet tek aspektet e besueshmërisë së sistemit dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike. Konkretisht, humbjet në shpërndarje janë ulur në 13.7%, duke përmbushur cakun e përcaktuar që niveli i humbjeve të shpërndarjes së energjisë të mos tejkalojë 14.5% deri në vitin 2024. Këto rezultate lidhen me investimet në modernizimin e rrjetit, mirëmbajtjen parandaluese dhe përmirësimin e menaxhimit të sistemit. Megjithatë, sfidat kryesore për të rritur më tej besueshmërinë në furnizim mbeten vonesat në rehabilitimin e kapaciteteve gjeneruese ekzistuese (TC Kosova A dhe TC Kosova B), dhe projektet e rinovimit të cilat nuk kanë filluar sipas afateve të parashikuara.

Po ashtu, progres dallohet edhe tek efienca e energjisë, por jo në shkallën e nevojshme për të reflektuar kursim më të madh të energjisë dhe për të arritur caqet e përcaktuara në Strategji. Përkundër rëndësisë, investimet në efienca në ndërtesa publike nuk janë të mjaftueshme, sepse mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të konsumit final. Fokusi kryesor duhet të zhvendoset te objektet rezidenciale dhe komerciale, të cilat njëherësh janë konsumuesit kryesorë të energjisë dhe ku potenciali për kursim është më i madh. Megjithëse kursimet në ndërtesat rezidenciale/komerciale kanë arritur objektivin afatshkurtër, ritmi aktual mbetet i ngadalshëm dhe sfidues për të arritur përmbushjen e objektivave afatgjatë të kursimeve të energjisë.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut, janë shënuar hapa pozitivë përfshirë blerjen e energjisë përmes bursës ALPEX nga viti 2024, ndonëse tregtimi përmes saj mbetet ende i kufizuar, si dhe në liberalizimin e tregut të energjisë në vitin 2025. Kapacitetet ndërkufitare nuk kanë arritur cakun e planifikuar të kapacitetit prej 28–30% për import dhe eksport. Kapaciteti aktual është 22-24% për eksport dhe 24-26% për import, që nënkupton se kufizimet teknike të linjave nuk arrijnë të lejojnë shfrytëzimin e potencialit të tregut të energjisë me kapacitet të plotë. Integrimi i plotë në tregun rajonal dhe arritja e caktit të kapacitetit ndërkufitar prej 70% të tregut të energjisë në të dy drejtimet deri në vitin 2031 mbetet një sfidë për t'u adresuar. Në aspektin social dhe të mbrojtjes së konsumatorëve, janë zhvilluar tre skema mbështetëse për kategoritë në nevojë, si dhe janë realizuar 17 fushata vetëdijësuese.

Ky raport konstaton se sfidat kryesore për zbatimin e strategjisë lidhen me vonesat e projekteve investive, zhvillimin e ngadaltë të kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE-të, ngecjen në vendosjen e një takse apo skeme të karbonit dhe përgatitjen ndaj ndikimit të CBAM, si dhe nevojat e larta financiare për realizimin e projekteve investive. Gjithashtu, në një aspekt më të përgjithshëm, duhet theksuar se Strategjia nuk mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjithë sektorët e ekonomisë, si transporti dhe industria, si dhe duke lënë jashtë projekte të promovuara në nivel politik, si termocentrali i gazifikimit të qymyrit, që nuk janë të reflektuara në dokumentin strategjik. Në këtë kuadër, rekomandohet prioritizimi dhe përsheptimi i angazhimit në arritjen e caqeve të Strategjisë, përfshi reforma si në përsheptimin dhe lehtësimin e proceseve të licencimit për projektet e BRE, investime në sistemin energjetik, krijimi i kushteve më të favorshme për investime në kapacitete të reja gjeneruese me BRE, identifikimi i zonave prioritare për investime, etj. Po ashtu, është thelbësore vendosja graduale e çmimit të karbonit dhe krijimi i një fondi për tranzicionin energjetik, si dhe forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë përmes programeve të mbështetjes direkte dhe masave të efiençës së energjisë.

Hyrje

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031 është dokumenti kyç që përcakton orientimet dhe masat për zhvillimin e sektorit energjetik në një periudhë dhjetëvjeçare.¹ Ky dokument mbështetet në kornizën ligjore për energjinë dhe planifikimin strategjik dhe zëvendëson strategjinë 2017–2026, si rezultat i nevojës për ristrukturim dhe përshtatje me ndryshimet e fundit në Kosovë, rajon dhe më gjerë, si dhe koordinim më të mirë me politika të tjera.²

Në kuadër të detyrimeve ndaj Komunitetit të Energjisë dhe obligimeve të Agjendës së Gjellbër, Kosova synon përafrimin me legjislacionin e BE-së për klimë, energji dhe mjedis, përfshirë instrumente si çmimi i karbonit dhe zbatimin gradual të rregullave që lidhen me emetimet.³ Duke pasur parasysh rrezikun e mekanizmave si CBAM dhe paqëndrueshmërinë e tregjeve gjatë krizës energjetike, strategjia thekson nevojën për një transformim të thellë të sistemit energjetik drejt më shumë qëndrueshmërie dhe diversifikimi më të madh.

Strategjia e Energjisë 2022–2031 synon të transformojë sektorin energjetik të Kosovës drejt një sistemi të qëndrueshëm, të pastër dhe ekonomikisht të përballueshëm, duke i dhënë përparësi zhvillimit të kapaciteteve gjeneruese të BRE-ve si energjia e erës dhe ajo solare përmes ankandëve dhe investimeve. Njëkohësisht, parashihen masa për reduktimin gradual të përdorimit të qymyrit, përfshirë modernizimin e njësive të termocentralit Kosova B dhe zvogëlimin e rolit të Kosovës A. Strategjia fokusohet gjithashtu në integrimin e tregut energjetik me Shqipërinë dhe zhvillimin e bursës së energjisë, për të cilin qëllim një hap fillestar dhe i rëndësishëm është bërë me themelimin e bursës ALPEX. Po ashtu, ajo synon rritjen e efijencës së energjisë, uljen e varësisë nga importi dhe fuqizimin e konsumatorëve përmes masave që garantojnë drejtësi sociale dhe përballueshmëri.

Strategjia është ndërtuar mbi pesë objektiva kryesore. Objektivi i parë synon të rrisë besueshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit me energji, duke e bërë sistemin më të qëndrueshëm dhe më fleksibil. Kjo arrihet përmes rritjes së fleksibilitetit, modernizimit të rrjetit dhe uljes së humbjeve, përmirësimit të kapaciteteve gjeneruese dhe forcimit të sigurisë kibernetike. Këtu parashihet rinovimi i njësive kryesore prodhuese, në këtë rast rinovimi i njësive të TC Kosova B dhe të paktën një njësie të TC Kosova A.⁴

Objektivi i dytë synon dekarbonizimin e sektorit të energjisë duke ulur emetimet e CO₂ dhe duke rritur rolin e BRE-ve, në mënyrë që energjia të bëhet më e pastër dhe më e qëndrueshme në afat të gjatë. Kjo arrihet përmes vendosjes graduale të taksës së karbonit, rritjes së energjisë së ripërtëritshme në prodhimin e energjisë elektrike dhe nxitjes së përdorimit të saj edhe për ngrohje.⁵

Objektivi i tretë synon rritjen e efijencës së energjisë dhe uljen e intensitetit energjetik, në mënyrë që të zvogëlohen nevojat për furnizim, emetimet dhe ndotja, si edhe varësia nga importi dhe kostoja për qytetarët dhe bizneset. Ky objektivi fokusohet në përmirësimin e efijencës në ndërtesa dhe në promovimin e kogjenerimit dhe ngrohjes qendrore efijente. Synohet kufizimi i konsumit final të energjisë dhe arritja e kursimeve, përfshirë certifikimin e ndërtesave me konsum afër zeros.⁶

¹ Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, f. 11-12

² Ibid., f.11

³ Ibid., f.33

⁴ Ibid., f. 30-33

⁵ Ibid., f. 33-35

⁶ Ibid., f. 35-38

Objektivi i katërt synon të forcojë bashkëpunimin rajonal dhe të përmirësojë funksionimin e tregut të energjisë, duke krijuar një treg të integruar dhe më konkurrues në përputhje me obligimet e Komunitetit të Energjisë. Kjo ndihmon sigurinë e furnizimit dhe përballueshmërinë, veçanërisht përmes integritetit me Shqipërinë dhe funksionimit të plotë të ALPEX-it. Objektivi përfshin edhe heqjen e barrierave të tregut dhe investime në aftësim profesional në fusha të energjisë, me fokus të veçantë të përfshirja e grave në këtë sektor.⁷

Objektivi i pestë synon të mbrojë dhe fuqizojë konsumatorët, duke vendosur qytetarët në qendër të reformave të sektorit të energjisë, sidomos ata në nevojë, që të përballojnë kostot e energjisë dhe të kenë qasje në zgjidhje më eficiente për energji dhe ngrohje. Ky objektivi parasheh përmirësime të skemave mbështetëse, programe për efikasitet dhe vetë-konsum, fushata informuese dhe masa tjera të ngjashme.⁸

Të gjitha objektivat e Strategjisë së Energjisë mbulojnë një periudhë gati dhjetëvjeçare (2022–2031) dhe për secilin objektivi përcaktohen caqe deri në vitin 2031. Megjithatë, brenda këtyre pesë objektivave kryesore, strategjia parasheh edhe masa dhe caqe konkrete afatshkurtra për vitet 2024 dhe 2025. Për të analizuar nëse këto caqe janë përmbushur deri në periudhën 2024/2025, në këtë raport është zbatuar një metodologji e kombinuar ku përfshihen: zhvillimi i intervistave me përfaqësues të KOSTT, ZRrE, Ministrisë së Ekonomisë dhe BERZh,⁹ mbledhja e të dhënave të dërguara përmes qasjes në dokumente publike nga ZRrE dhe Ministria e Ekonomisë, si dhe shqyrtimi i dokumenteve dhe raporteve relevante institucionale ku përfshihen strategji, raporte progresi, plane të zbatimit dhe materiale mbështetëse si për Kosovën ashtu edhe për shtetet e rajonit. Nga gjithsej 24 indikatorë të analizuar, të dhënat për shumicën prej tyre janë të përditësuara dhe pasqyrojnë arritjet deri në fund të vitit 2025. Përrjashtim bëjnë tre indikatorë, për të cilët të dhënat më të fundit i përkasin vitit 2024. Gjithashtu, në këtë analizë nuk janë përfshirë të gjithë indikatorët e dokumentit të Strategjisë, por është bërë një përzgjedhje duke u fokusuar në indikatorë kryesorë të matshëm, të mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe kryesisht numerike. Indikatorët me natyrë procedurale, për të cilët mungojnë të dhëna të standardizuara, janë përrjashtuar për të ruajtur objektivitetin dhe krahasueshmërinë.

Në analizë, sfidat janë trajtuar sipas natyrës së tyre, duke përfshirë sfidat në zbatimin e objektivave të strategjisë, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e kapaciteteve institucionale, vonesat dhe mungesën e burimeve, dhe sfidat që burojnë nga vetë dokumenti i strategjisë, si mungesa e koherencës ndërmjet objektivave, mos-përfshirja e sektorëve kyç (si transporti dhe industria), si dhe mospërputhja me realitetin në terren. Përtej vlerësimit të progresit në raport me objektivat e përcaktuara, ky raport synon të shtrojë edhe një pyetje më themelore lidhur me vetë kornizën strategjike: në çfarë mase Strategjia e Energjisë 2022–2031 vazhdon të përfaqësojë një qasje të duhur për zhvillimet aktuale në sektorin energjetik në Kosovë. Duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta në tregjet energjetike, si dhe rritjen e presioneve për dekarbonizim, analiza nuk kufizohet vetëm në matjen e progresit të caqeve të objektivave të vendosura, por gjithashtu shqyrton në mënyrë kritike relevancën dhe përshtatshmërinë e tyre.

⁷ Ibid., f. 38–40

⁸ Ibid., f. 40–44

⁹ Intervistat janë zhvilluar me Arbëresha Isufi (Drejtuese e Divizionit të Politikave të Energjisë në Ministrinë e Ekonomisë së Kosovës), Trim Ternava (Shef Ekzekutiv i KOSTT), Sergiy Maslichenko (Shef për Kosovën në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZh), si dhe Petrit Pepaj (Drejtor Ekzekutiv në ZRrE).

Progresi i realizimit të objektivave strategjike


Objektivi I. Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit

— Objektivi specifik: Rritja e fleksibilitetit të sistemit

Si pjesë e përmirësimit të besueshmërisë së sistemit energjetik, përdoren dy tregues kryesorë: SAIDI, i cili i referohet indeksit mesatar të kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem, dhe SAIFI, apo indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve.¹⁰ SAIDI mat kohëzgjatjen totale të ndërprerjeve të energjisë që përjeton mesatarisht një konsumator gjatë një periudhe të caktuar, zakonisht një vit, ndërsa SAIFI tregon numrin mesatar të ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike me të cilat përballet një konsumator gjatë vitit.¹¹

Sipas Strategjisë së Energjisë 2022–2031, objektivi për vitin 2024 ishte që kohëzgjatja mesatare vjetore e ndërprerjeve të energjisë elektrike për konsumator (SAIDI) të mos tejkalonte 68.9 orë në vit. Të dhënat më të fundit tregojnë se vlera aktuale e SAIDI është 39.45 orë në vit, duke dëshmuar përmirësim të qëndrueshmërisë së furnizimit dhe përmbushje të objektivit të përcaktuar. Në anën tjetër, sa i përket frekuencës së ndërprerjeve (SAIFI), synohej që deri në vitin 2024 konsumatorët të mos përballen më shumë se 49 ndërprerje gjatë vitit. Sipas të dhënave të vitit 2025, SAIFI regjistrohesh në 36.53 ndërprerje në vit, çka nënkupton se objektivi jo vetëm është arritur, por edhe është përmirësuar përtej nivelit të synuar.¹²

Figura 1. Treguesit e ndërprerjeve në sistemin e energjisë elektrike



Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE)

Ky progres është rezultat i zbatimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse që kombinon ndërhyrjet teknike dhe masat organizative në menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes. Në aspektin teknik, progresi është rezultat i ndërhyrjeve në rrjetin e shpërndarjes, ku mirëmbajtja parandaluese dhe kontrollet e rregullta kanë mundur identifikimin dhe adresimin në kohë të defekteve, duke reduktuar ndërprerjet me ndikim të lartë. Investimet në modernizim të rrjetit si zëvendësimi i pajisjeve të vjetruara dhe shtrirja e kabllave nëntokësore në zonat problematike, kanë rritur besueshmërinë e furnizimit. Po ashtu, automatizimi i rrjetit përmes pajisjeve inteligjente dhe

¹⁰ MPSC. Distribution System Reliability Metrics

¹¹ Ibid.

¹² Të dhënat janë siguruar nga ZRE përmes kërkesës për qasje në të dhëna publike.

sistemeve SCADA ka përshpejtuar identifikimin, izolimin dhe rikthimin e furnizimit në rast defekti, duke ndikuar në uljen e SAIDI-t dhe në përmirësimin e SAIFI-t. Në aspektin organizativ, reagimi i shpejtë i ekipeve në terren dhe koordinimi më i mirë i ndërprerjeve të planifikuara kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e performancës operative. Njëkohësisht, përdorimi i analizave të avancuara të të dhënave për të identifikuar zonat problematike ka mundësuar planifikim më të mirë dhe ndërhyrje më efikase, duke përforcuar më tej qëndrueshmërinë e sistemit.

— Objektivi specifik: Modernizimi i rrjeteve dhe reduktimi i humbjeve në rrjet

Ngjashëm me përmirësimin e treguesve kryesorë të ndërprerjeve në sistem, edhe reduktimi i humbjeve të energjisë elektrike ka qenë një objektivi i rëndësishëm në kuadër të përmirësimit dhe modernizimit të rrjetit elektrik. Në Strategjinë e Energjisë 2022-2031 ishte përcaktuar që deri në vitin 2024 humbjet në rrjetin e shpërndarjes të mos tejkalojnë 14.5%. Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se niveli i humbjeve ka arritur në rreth 13.7%, duke shënuar një ulje prej afro 5 pikë përqindje krahasuar me nivelin e humbjeve të vitit 2021 (18.5%).¹³ Caku i paraqitur për vitin 2024 është përmbushur si rezultat i ndërhyrjeve teknike në rrjetin e shpërndarjes, pra arsyet e njëjta të cilat kanë ndikuar edhe në përmirësimin e treguesve tjerë të sistemit të furnizimit me energji elektrike.

Figura 2. Humbjet në shpërndarje të energjisë elektrike




Burimi: Ministria e Ekonomisë

Ndonëse objektivi afatshkurtër është përmbushur, caku që deri në vitin 2031 niveli i humbjeve të energjisë elektrike të mos tejkalojë 9% mbetet sfidues.¹⁴ Kjo për shkak që struktura e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë dominohet nga amvisëritë, sektor nga i cili keqpërdorimet ende mbesin të mëdha dhe e sfidojnë reduktimin e humbjeve jo-teknike. Për të adresuar këtë çështje, duhet vazhdimësi e investimeve në modernizim të rrjetit të transmissiionit dhe të shpërndarjes, si dhe procedura sa më të lehta për kyçe të vetëgjeneruesve/prosumatorëve.

¹³ Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Ekonomisë (Departamenti i Energjisë) përmes kërkesës për qasje në të dhëna publike.

¹⁴ Sasia e energjisë së humbur në shpërndarje dhe transmissiion në nivel të Bashkimit Evropian është rreth 6%. [World Bank Indicators](#), 2023

Figura 3. Konsumi i energjisë elektrike sipas sektorëve, 2025



Burimi Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Objektivi specifik: Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike

Për të përmirësuar besueshmërinë e sistemit dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit, njëherësh për të arritur objektivat e paraqitura në Strategjinë e Energjisë 2022-2031, investimet në kapacitetet kryesore gjeneruese janë thelbësore. Sipas dokumentit të strategjisë, është parashikuar rinovimi i dy njësive të TC Kosova B, përkatësisht njësitë B1 dhe B2, me synim që deri në fund të vitit 2025 ose më së largu deri në 2026, këto dy njësi të operojnë në mënyrë efikase. Po ashtu, është parashikuar që një njësi e TC Kosova A të rinovohet deri në fund të vitit 2024. Deri tash, projekti për rehabilitimin/rinovimin e këtyre njësive ende nuk ka filluar.

Në kuadër të ndërhyrjeve të vazhdueshme të rinovimeve, gjatë vitit 2025 është bërë remonti i njësive B1.¹⁵ Në vitin 2024 është zëvendësuar transformatori i ndërtuar në vitet 1970-ta në TC Kosova A, me qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike.¹⁶ Megjithatë, këto ndërhyrje nuk janë pjesë e projektit të plotë të rehabilitimit të këtyre njësive, siç parashikohet në Strategjinë e Energjisë.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Ekonomisë, për njësinë A3 pritet që gjatë vitit 2026 të nënshkruhet kontrata me konsorciumin për implementimin e projektit të rehabilitimit dhe modernizimit. Ndërkohë, për njësinë B1 parashihet realizimi i projektit të elektrofiltrit DeNOx dhe modernizimi i turbinës në periudhën prill–dhjetor 2026, ndërsa njësia B2 pritet të rinovohet në periudhën prill–nëntor 2027.¹⁷ Vonesat në zbatimin e projektit janë shkaktuar nga falimentimi i njërit prej anëtarëve të konsorciumit përgjegjës për implementim, si dhe nga kërkesat për shpenzime shtesë të paraqitura nga operatori ekonomik.

Mosrealizimi i këtyre investimeve rrezikon besueshmërinë e sistemit energjetik, pasi njësitë gjeneruese do të vazhdojnë të operojnë me pajisje të amortizuara, duke rritur gjasat për defekte dhe ndërprerje të paplanifikuara, si dhe duke ulur disponueshmërinë e kapaciteteve.¹⁸ Njëkohësisht, vonesat cenojnë përmbushjen

¹⁵ Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. Përfundoi me sukses remonti i njësive B1, para afatit të parashikuar. 2025

¹⁶ Ibid. Përfundon me sukses një projekt i rëndësishëm në TC Kosova A. 2024

¹⁷ Bazuar në të dhëna të siguruar nga Ministria e Ekonomisë, Departamenti i Energjisë.


¹⁸ Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, f.18,

e standardeve mjedisore, pasi mungesa e modernizimit si p.sh. elektrofiltrat dhe sistemet DeNOx, rrit rrezikun e tejkalimit të kufijve të emetimeve të përcaktuar sipas Direktivës Industriale të Emetimeve të BE-së.¹⁹

Objektivi II. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE-të) përbëjnë një alternativë kyçe për diversifikimin e energjisë dhe për dekarbonizimin gradual të sistemit energjetik në Kosovë.²⁰ Qëllimi afatgjatë është që deri në vitin 2050 të eliminohet plotësisht përdorimi i qymyrit, i cili aktualisht është burimi kryesor i energjisë në vend.²¹ Sipas të dhënave më të fundit, pjesëmarrja e BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike është 8%, e cila, krahasuar me pikën fillestare të vitit 2021, ka shënuar rritje prej vetëm 1 pikë përqindjeje. Kjo shifër mbetet larg objektivit të parashikuar në Strategjinë e Energjisë për vitin 2024, ku theksohet që pjesëmarrja minimale e BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike duhet të jetë 13%.²² Gjithashtu, Kosova qëndron larg nivelit të BE-së ku pjesëmarrja e BRE-ve në gjenerimin e energjisë elektrike është mesatarisht 47.2%.²³

Figura 4. Pjesëmarrja e BRE-ve në konsumin e energjisë elektrike (në përqindje)



Burimi: Ministria e Ekonomisë

Objektivi specifik: Promovimi i energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë elektrike

Gjithashtu, gjithsej kapaciteti i BRE-ve, i parashikuar të arrijë 490 MW deri në vitin 2025, nuk është arritur. Aktualisht, në nivel vendi, kapaciteti i instaluar i BRE-ve është ekuivalent me 330 MW.²⁴ Ndonëse viteve të fundit Kosova ka pasur rritje graduale të kapacitetit të BRE-ve, prapë kjo rritje nuk arrin të përmbushë objektivat e Strategjisë së Energjisë dhe nuk mjafton që Kosova të përafrohet me shtetet e rajonit në kapacitetet e BRE-ve.²⁵

¹⁹ Për më shumë rreth kërkesave të direktivës, shih Direktivën e BE 2018/2022.

²⁰ Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031

²¹ Ibid.

²² Ibid.

²³ Eurostat, 47% of EU's electricity came from renewables in 2025, 2026

²⁴ Këtu përfshihen edhe prodhuesit vetë-konsumues (prosumatorët).

²⁵ International Renewable Energy Agency (IRENA), Renewable Energy Statistics 2025.

Në rritjen graduale të kapacitetit prodhues të BRE-ve kanë ndikuar kryesisht turbinat me erë SOWI Kosova, që kanë hyrë në funksion në vitin 2021, kapaciteti i prodhimit i të cilave sipas të dhënave të fundit është 103.41 MW.²⁶ Gjithsej, fuqia e instaluar e hidrocentraleve dhe turbinave me erë është ekuivalent me 202.98 MW. Aktualisht, ka disa projekte të BRE në proces, me kapacitet mbi 700 MW²⁷, ku shumica prej tyre janë ende në fazat administrative të marrjes së licencave apo lejeve, pa filluar ende punën në terren për ndërtimin e kapaciteteve. Ndërkohë, si përpjekje për të rritur kapacitetet e BRE-ve dhe për t'i arritur objektivat e parashikuara në Strategjinë për Energji, në vitin 2024 ka përfunduar ankandi i parë solar në Kosovë me kapacitet 100 MW. Këtë ankand e fitoi një konsorcium prej katër kompanive nga Zvicra, Gjermania dhe Kosova, me një çmim prej 48.88 euro/MWh.²⁸ Sipas burimeve të Ministrisë së Ekonomisë, ofertuesi fitues i ankandit planifikohet të fillojë prodhimin në tetor të vitit 2026, dhe ky afat mund të shtyhet më së largu deri në maj të vitit 2027. Megjithatë, të dhënat nga terreni tregojnë se gjatë vitit 2025, dhe në pjesën e parë të vitit 2026, ende nuk ka filluar ndërtimi i këtij parku solar. Sipas ME, pjesa administrative e procesit është në finalizim, ku po finalizohet kontrata për inxhinieri, prokurim dhe ndërtim. Për më shumë, edhe komuna e Rahovecit ku do të ndërtohet ky park, i ka përfunduar procedurat për ndarjen e tokës për shfrytëzim për një periudhë 34 vjeçare. Përkundër përfundimit të këtyre procedurave, ndërtimi i parkut ende nuk ka filluar, dhe sipas disa burimeve, një ndër arsyt kryesore për këtë vonesë janë mosmarrëveshjet në mes të investitorëve.²⁹ Tutje, kanë filluar procedurat për ankandin e erës me kapacitet 100 MW, ku Ministria e Ekonomisë ka publikuar kërkesën për propozime të ofertave teknike dhe financiare në fund të vitit 2025, pas përfundimit të procesit të parakualifikimit të tre ofertuesve.³⁰

Kosova është ende në faza të hershme dhe përdor një proces ku ofertuesit garojnë duke ofruar çmime konkurruese; oferta me çmimin më të ulët shpallet fituese.³¹ Sipas Ministrisë së Ekonomisë, ndryshe nga kapacitetet solare të ndërtuara mbi të ashtuquajturën tarifë feed-in, të cilat arrinin një kosto prej 161.6 €/MWh, prodhimi i energjisë solare nga fituesi i ankandit do të ketë një çmim prej 48.88 €/MWh.³² Kontrata mbi të cilën është realizuar ky ankand mbështetet në një kontratë PPA, me plan që në të ardhmen të konvertohet në një kontratë CfD.³³ PPA janë marrëveshje afatgjata ku një prodhues i energjisë krijon marrëveshje të shesë energjinë te blerësi me një çmim të caktuar. Ndërsa, CfD janë marrëveshje financiare me shtetin që ndihmojnë prodhuesin të mos humbasë nga luhatjet e çmimeve, që do të thotë i garantojnë të ardhura më të qëndrueshme prodhuesit.³⁴

Në rastin e Kosovës, blerësi (në këtë rast KOSTT) blen energjinë nga investitori për një periudhë 15-vjeçare. I gjithë prodhimi dorëzohet në rrjet, që do të thotë se investitorit nuk i duhet të kërkojë vetë klientë, pasi energjia shitet përmes kontratës. Në rast se çmimi i tregut është nën çmimin e caktuar, diferencën e mbulon KOSTT, në të

26 Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE). Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike për vitin 2025. f.7

27 International Monetary Fund (IMF). Republic of Kosovo: 2026 Article IV Consultation-Press Release; Staff Report; and Statement by the Executive Director for the Republic of Kosovo. IMF Staff Country Reports 2026

28 The Renewable Energy Source in Kosovo (RESKosovo). Ankandi i parë solar në Kosovë.

29 Radio Evropa e Lirë. Asnjë panel në fushë: Cfarë po ndodh me parkun diellor millionësh në Rahovec? 2026

30 The Renewable Energy Source in Kosovo (RESKosovo). Ankandi i erës 100 MW.

31 The Renewable Energy Source in Kosovo (RESKosovo). Competitive Bidding Process. Internal Number 01-001-2023. 2023

32 Çmimi tavan i propozuar nga ZRE për këtë ankand ka qenë 75 euro për MWh, ndërsa fituesi ofron çmim për 35% më të ulët. Ministria e Ekonomisë. Sqarim lidhur me procesin e Ankandit për ndërtimin e parkut solar me kapacitet 100 MW. 2025

33 Kontratë për Diferencë (ang. Contract for Difference)

34 European Parliament. Overview of the diffusion of Power Purchase Agreements and Contracts for Difference across Member States. 2026. p.11

kundërt, nëse çmimi i tregut është mbi këtë nivel, investitori e kthen diferencën.³⁵ Të dy ankandet janë shumë të rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së BRE-ve dhe për diversifikimin e sektorit energjetik të Kosovës. Caku për vitin 2031 është që pjesëmarrja e BRE-ve të arrijë të paktën 35%. Megjithatë, mosrealizimi i objektivave deri më tani e bën këtë objektiv afatgjatë shumë sfidues për t'u arritur.³⁶

Sipas BERZH, kushtet e përcaktuara nga kontrata PPA në Kosovë, së bashku me procedurat burokratike, si kërkesat për leje ndërtimi, çështjet pronësore dhe të tjera të ngjashme, ndikojnë që investorët të shmangin financimin direkt nga qeveria. Ata shpesh distancohen nga kjo formë e investimit përmes ankandëve dhe kërkojnë forma të tjera private të financimit për të realizuar projektet e tyre.³⁷ Për dallim, Shqipëria është duke kaluar drejt modelit CfD, drejt një sistemi më të hapur të tregut, ku gjysma e energjisë i shitet operatorit të transmissiionit vendor me çmim 24.89 €/MWh, ndërsa gjysma tjetër shitet në treg me konkurrencë të lirë.³⁸ Ky tranzicion, me metodologji të mbështetur nga BERZH, siguron qëndrueshmëri dhe tërheqje për investorët, si dhe përgatitje për integrim në tregun evropian përpara anëtarësimit të Shqipërisë në BE.³⁹

Sipas Ministrisë së Ekonomisë, arsyet kryesore që kanë vonuar realizimin e projekteve të BRE-ve janë: vonesat në procedura dhe leje, kapacitetet e kufizuara të rrjetit, sfidat pronësore, si dhe tjera të ngjashme.⁴⁰ Kjo situatë, kur projektet marrin kohë të gjatë të realizimit të tyre, flet edhe për mungesën e një qasje më proaktive të institucioneve qeveritare për të kryer reforma që thjeshtëzojnë procese të licencimit, eliminojnë burokracinë institucionale, dhe ofruar incentiva fiskale dhe të tjera për investorët.

Tabela 1. Disa projekte ekzistuese të BRE-vë në Kosovë, sipas progresit në zbatim

Projekti	Lloji i projektit	Kapaciteti	Faza e implementimit
Projekti në Kramovik përmes ankandit	Solar	100 MW	Në fazën administrative
Projekti i parkut solar të KEK	Solar	100 MW	Në fazën fillestare/ideore
Projekti nga energjia me erë përmes ankandit	Me erë	100 MW	Në fazën administrative
Projektet Zatriqi 1 dhe 2	Me erë	Gjithsej 70 MW, nga 35MW për secilin	I përfunduar (hyn në operim në korrik 2026)
Projekti SEGE në Bec	Solar	150 MW	Në proces ndërtimi
Projekt në Istog	Solar	150 MW	Në fazën fillestare/ideore
Projekt në Junik	Solar	100 MWp	Në fazën fillestare/ideore

Burimi: ZRrE, KEK, BERZH

35 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE). Kjo Marrëveshje për blerjen e energjisë (PPA) do të kalojë në të ashtuquajtur Kontratë për Diferencë (CfD) pasi ZRrE të konfirmojë krijimin e një tregu funksional "day-ahead". Ky kalim është projektuar për të siguruar që ofertuesi i përzgjedhur të mos ndikohet negativisht.

36 Ministria e Ekonomisë. Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2026-2028.

37 Informacione nga intervista me përfaqësues të BERZH.

38 SEELegal. [Photovoltaic Park of Karavasta – SEE Legal](#)


39 Energy Community. [Albania moves closer to a fully market-based support scheme for renewables](#), 2025

40 Informacion nga intervista e zhvilluar me përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë.

Ndërkaq vetëm gjatë vitit 2025, sipas të dhënave të ZRrE, pas finalizimit të projekteve sipas Autorizimit nga Bordi i ZRrE-së dhe pas pranimit teknik, kanë hyrë në operim komercial gjashtë projekte nga panelet solare, me fuqi totale të instaluar prej 21.48 MW. Gjithashtu, ZRrE gjatë vitit 2025 ka trajtuar kërkesat për gjeneratorët të konsumatorëve vetë-prodhues, duke autorizuar ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum të gjithsej 283 projekteve me gjithsej janë instaluar kapacitete prej 11 MW.⁴¹

Ndryshe nga kapaciteti i përgjithshëm i BRE-ve, kapaciteti i prodhuesve vetë-konsumues (prosumatorëve) ka shënuar rritje të konsiderueshme në vitet e fundit, duke arritur 34 MW dhe tejkaluar targetin prej 30 MW të parashikuar për vitin 2025. Për krahasim, në vitin 2021 ky kapacitet ishte vetëm 2 MW.⁴² Sipas ZRrE-së, rritja e kapaciteteve të prosumatorëve është kryesisht rezultat i incentivave qeveritare për subvencionimin e kapaciteteve gjeneruese të BRE-ve, përfshirë mbështetjen financiare për panele solare, lehtësimin e procedurave administrative dhe përmirësimin e lidhjes me rrjetin elektrik, çka ka nxitur individët të investojnë më shumë dhe të rrisin pavarësinë energjetike. Për më shumë, hulumtimet tregojnë që arsyet shtesë të cilat kanë ndikuar që numri i prosumatorëve të rritet në vitet e fundit është rezultat i uljes së kostove të teknologjive fotovoltaike, duke i bërë instalimet në kapacitete të ripërtëritshme më të favorshme financiarisht edhe për bizneset e vogla.⁴³ Në të njëjtën kohë, thjeshtimi i procedurave për lidhje në rrjet dhe futja e mekanizmave mbështetës të matjeve kanë ulur si barrierat administrative ashtu edhe ato teknike për hyrje në treg.⁴⁴ Gjetjet gjithashtu tregojnë se rritja e ndërgjegjësimit për kursimet afatgjata të energjisë dhe shqetësimet për sigurinë energjetike si pasojë edhe e liberalizimit të tregut të energjisë kanë nxitur më tej përdoruesit që të investojnë në sisteme të decentralizuara të prodhimit të energjisë, e veçanërisht në energji solare.⁴⁵

Figura 5. Kapaciteti i prodhuesve vetë-konsumues (prosumatorëve) (MW)



Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE)

Nëse analizojmë vendet e rajonit, si për shembull Shqipëria, vërehet që zhvillimi i ankandeve për energjinë e ripërtëritshme ka marrë një hov të dukshëm vitet e fundit. Në vitin 2020 u organizua ankandi i parë për energji solare me kapacitet 140 MW, i cili u pasua nga ankandi për energjinë e erës me kapacitet 222.5 MW,

⁴¹ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). *Raporti vjetor 2025*, f.10-11

⁴² Të dhënat janë siguruar nga ZRrE përmes kërkesës për qasje në të dhëna publike.

⁴³ Pozhegu, D., Neziri- Vela, Sh., et al. *From Consumer to Prosumer: Unlocking the Potential of Solar Energy in Kosovo's Energy Market*. 2025

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Ibid.

i përfunduar në vitin 2023. Së fundmi, në fillim të vitit 2024, është lansuar edhe një ankand i ri solar me kapacitet 300 MW. Në tërësi, këto iniciativa përbëjnë rreth 640–660 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme, duke dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm drejt tranzicionit energjetik.⁴⁶ Sipas BERZH, i cili njëkohësisht ka mbështetur ankandin e parë të energjisë së erës në Shqipëri, ky ankand përfaqëson një histori suksesi për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ai ka shënuar çmime të ulëta rekord prej 44.88 euro/MWh, ka tërhequr investitorë vendas dhe ndërkombëtarë dhe ka rritur ndjeshëm konkurrueshmërinë e tregut në sektorin e energjisë së pastër.⁴⁷ Megjithatë, në tërësi, projektet e përzgjedhura përmes ankandëve në Shqipëri ndodhen ende në faza relativisht të hershme të implementimit.⁴⁸ Vetëm një numër i kufizuar projektesh kanë siguruar financimin e plotë dhe kanë hyrë në fazën konkrete të zbatimit, ndërsa shumica e projekteve solare të dhëna së fundmi mbeten në faza të avancuara zhvillimi, kryesisht në proceset e lejeve dhe sigurimit të financimit. Projektet e energjisë së erës, në veçanti, pritet të hyjnë në fazën e implementimit më vonë gjatë dekadës, çka tregon se një pjesë e konsiderueshme e portofolit mbetet ende në nivel planifikimi dhe zhvillimi, më shumë sesa në fazë të përfundimit apo operimit.

Në të njëjtën kohë, edhe vendet e tjera të rajonit po ndjekin hapa të ngjashëm. Serbia ka realizuar deri më tani dy ankande, një në vitin 2023⁴⁹ dhe një tjetër në vitin 2024,⁵⁰ të cilat përfshijnë projekte të kombinuara të energjisë solare dhe të erës, me një kapacitet të përgjithshëm prej afro 900 MW.⁵¹ Krahasuar me Shqipërinë, portofoli i projekteve të ankanduara në Serbi konsiderohet më i avancuar, pasi disa projekte të mëdha tashmë kanë siguruar financimin dhe ndodhen në ndërtim ose pranë fillimit të punimeve, veçanërisht ato të fazave të para të ankandëve.⁵² Një nga parqet me erë me kapacitet 94MW ka filluar me sukses prodhimin.⁵³ Megjithatë, edhe në Serbi ekzistojnë sfida të caktuara jo teknike, si çështjet e lejeve, koordinimit institucional apo çështje procedurale, të cilat mund të ndikojnë në vonesa të pjesshme, pa e ndryshuar faktin se Serbia paraqet një portofol më të konsoliduar dhe më afër implementimit krahasuar me vendet tjera të rajonit.

Mali i Zi, nga ana tjetër, ka lansuar në vitin 2025 ankandin e parë për energji solare me kapacitet 250 MW.⁵⁴ Ndërkohë, Maqedonia e Veriut ende nuk ka zhvilluar ankande të tilla, por është në proces të hartimit të kornizës përkatëse ligjore dhe rregullatore, duke sinjalizuar përgatitje për hapa të ardhshëm në këtë drejtim.⁵⁵

Përgjithësisht, kapacitetet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike në vendet e rajonit kanë shënuar rritje në vitet e fundit, megjithëse me ritme të ndryshme zhvillimi. Serbia mban nivelin më të lartë të kapaciteteve dhe paraqet rritje të qëndrueshme. Gjithashtu Shqipëria ndjek një trend të ngjashëm me zgjerim gradual të kapaciteteve. Mali i Zi mbetet relativisht stabil me ndryshime minimale ndër vite, ndërsa Maqedonia e Veriut shfaq rritje më të dukshme në vitet e fundit.

46 European Bank for Reconstruction and Development (EBRD). [Albania announces results of first onshore wind auction](#). 2023

47 Ibid.

48 Informacion i siguruar nga BERZH në Kosovë.

49 European Bank for Reconstruction and Development (EBRD). [Serbia launches first 450 MW renewables auction, designed with EBRD support](#). 2023

50 Ibid. [Serbia completes second renewables auction with EBRD support](#). 2025

51 Ibid.

52 Informacion i siguruar nga BERZH në Kosovë.


53 Bajic, V. [Serbia's Pupin wind farm starts trial operation](#). 2024.

54 Ibid. [EBRD supports first renewable energy auction in Montenegro](#). 2025

55 Albanian Energy Association (AEA). [North Macedonia's draft law envisages renewable energy auctions for CfDs](#). 2025

Kosova pavarësisht rritjes graduale në vitet e fundit, vazhdon të mbetet vendi me kapacitetet më të ulëta të burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike në rajon.

Figura 6. Kapaciteti i BRE-ve në prodhimin e energjisë elektrike në rajon (MW), 2020-2024



Burimi: Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Ripërtëritshme (IRENA)

Objektivi specifik: Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të energjisë së ripërtëritshme për ngrohje

Sektori i ngrohjes karakterizohet nga dominimi i sistemeve individuale, ndërsa ngrohja qendrore mbetet e zhvilluar në mënyrë shumë të kufizuar, duke qenë e instaluar vetëm në rreth 3–5% të vendbanimeve dhe për pasojë, shumica e familjeve mbështeten në pajisje të veçanta dhe shpesh joefikase për ngrohje dhe gatim, kryesisht duke përdorur energji elektrike, dru zjarri dhe në disa raste edhe qymyr.⁵⁶ Sipas Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2022–2031, është parashikuar integrimi i BRE-ve të energjisë si biomasa, energjia gjeotermike dhe pompat termike solare në sistemet e ngrohjes qendrore, me synim rritjen e kapaciteteve të instaluar nga 15MWth në vitin 2021 në të paktën 65MWth deri në vitin 2025. Megjithatë, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se ky kapacitet ka mbetur i pandryshuar në nivelin fillestar prej 15MWth, duke reflektuar një mospërmbushje të konsiderueshme të objektivave të vendosura. Kjo ngecje tregon se progresi në zhvillimin e projekteve të ngrohjes qendrore me BRE ka qenë i kufizuar për shkak të mungesës së investimeve dhe projekteve të BRE-ve, pengesave institucionale e rregullative dhe varësisë nga financimet e donatorëve. Në këtë kontekst, stagnimi i vazhdueshëm sugjeron nevojën për të rishikuar jo vetëm mekanizmat e zbatimit, por edhe vetë pritshmëritë strategjike të parashikuara në dokumentin e strategjisë. Një projekt që është në proces dhe do të ndikojë në arritjen e këtij objekti është projekti 'Solar 4 Kosovo II'. I njëjti pritet të jetë ndër impiantet më të mëdha solare në Evropë dhe i pari në rajon për nga kapaciteti, i financuar nga KfW dhe BERZh, përmes Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), dhe pritet të përfundojë në shkurt të vitit 2028.^{57,58} Projekti do të përdorë energji të pastër solare për prodhimin e energjisë ngrohëse, duke instaluar panele solare në një sipërfaqe prej 63 mijë m². Përmes këtij integrimi midis sistemit të energjisë solare dhe atij të kogjenerimit, pritet të krijohet një kapacitet shtesë termik prej 50MWth dhe të ketë ndikim te më shumë se 38 mijë konsumatorë të rinj.⁵⁹

⁵⁶ Organization for Economic Co-operation and Development (OECD). *Multi-dimensional Review of the Western Balkans*. 2022. f.483.

⁵⁷ Termokos. *Solar 4 Kosovo II*.

⁵⁸ Western Balkans Investment Framework. *Kosovo, Solar4Kosovo – Photovoltaic Plant*. 2026

⁵⁹ Ibid.

Objektivi III. Rritja e efijencës të energjisë

Në Strategjinë e Energjisë 2022–2031, përmirësimi i efijencës të energjisë është një tregues që lidhet drejtpërdrejt me synimin që vendi të ketë kërkesë më të menaxhueshme, kosto më të ulëta dhe më shumë siguri furnizimi.⁶⁰ Niveli i konsumit final të energjisë është i rëndësishëm sepse tregon sa energji shkon realisht te përdoruesit fundorë, si amvisëritë, transporti, industria dhe shërbimet, pasi llogariten humbjet në prodhim dhe në rrjet. Qëllimi është që konsumi final të mos tejkaloj 1,877 ktoe deri në vitin 2031. Sipas të dhënave më të fundit të vitit 2024, konsumi final aktual është ekuivalent me 1,472.72 ktoe, ndonëse vitet e fundit vërehet rritje në konsumin e energjisë. Megjithatë, marrë parasysh që objektivi për vitin 2024 është që konsumi të mos e tejkalonte 1,709 ktoe, atëherë caku për këtë vit është arritur.

Figura 7. Niveli i konsumit final të energjisë (ktoe)



Burimi: Ministria e Ekonomisë

Për më tepër, kursimet kumulative të energjisë të arritura në sektorin e ndërtimit janë një tregues i drejtpërdrejtë i efektit të masave të efijencës, si renovimet energjetike, izolimi, ndërrimi i dritareve, përmirësimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes, si dhe modernizimi i pajisjeve në ndërtesa publike, private dhe komerciale. Në Strategjinë e Energjisë 2022–2031, ky objektiv lidhet me synimin për të ulur kërkesën për energji, zvogëluar shpenzimet dhe lehtësuar presionin mbi furnizimin, sidomos gjatë sezonit të ngrohjes. Sipas të dhënave të vitit 2025, kursimi aktual është ekuivalent me 36.01 ktoe, çka tregon se janë bërë hapa krahasuar me pikën fillestare të vitit 2021, kur niveli i kursimit ishte vetëm 2.7 ktoe, dhe është tejkaluar caku prej 17.76 ktoe i cili parashihej deri në vitin 2024.

Objektivi specifik: Përmirësimi i efijencës së energjisë në ndërtesa

Për dallim, objektivi që deri në vitin 2024 të kemi të paktën 10 ndërtesa me konsum energjie afër zeros nuk është arritur. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, aktualisht nuk ka asnjë ndërtesë që e plotëson këtë standard për arsye se raportimi i këtij indikator varet nga zbatimi i Certifikimit të Performancës Energjetike (CPE) dhe hartimi i planit për këto ndërtesa, procese që janë ende në zhvillim. Kosova është në fazën e përgatitjes së legjislacionit sekondar me mbështetje të GIZ si dhe në fazën e përgatitjes së Draft Strategjisë për Renovimin e Ndërtesave, me mbështetje nga LuxDev. Pasi të funksionalizohet plotësisht procesi i CPE-së, duke përfshirë edhe trajnimin dhe licencimin e vlerësuesve të energjisë, do të nisë certifikimi i ndërtesave

⁶⁰ Ministria e Ekonomisë, *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031*

të reja, ekzistuese dhe atyre që i nënshtrohen renovimeve të mëdha. Vetëm pas realizimit të këtyre hapave do të krijohen kushtet që masat që ndërtesat me konsum të energjisë afër zero të mund të maten dhe raportohen si indikatorë.

Në anën tjetër, përkundër rritjes së konsumit të energjisë, sinjale pozitive lidhur me efikasitetin tregojnë kursimet kumulative në ndërtesat publike,⁶¹ të cilat janë rezultat i investimeve në efikasitet.⁶² Që nga viti 2020, me themelimin e Fondit të Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE), janë ndërmarrë masa të ndryshme për rritjen e efikasitetit, prej tyre vetëm në nivel lokal, FKEE ka zbatuar masa në 85 ndërtesa, përfshirë izolimin, ndërrimin e dyerve dhe dritareve, si dhe modernizimin e sistemeve të ngrohjes, me një vlerë totale prej 13.5 milionë euro, të financuara nga BE-ja, Banka Botërore dhe Qeveria e Kosovës.⁶³ Megjithatë, drejtimi i investimeve të efikasitetit në sektorin publik nuk është i mjaftueshëm për të arritur cakun që konsumi final i energjisë deri në vitin 2031 të mos tejkalojë 1,877 ktoe.⁶⁴

Sipas OECD-së, ekonomitë familjare konsumojnë rreth 38% të energjisë finale, kryesisht për shkak të ngrohjes joefikase dhe ndërtesave të paizoluara.⁶⁵ Në Strategjinë e Energjisë 2022- 2031 është parashikuar që kursimet e energjisë në sektorin rezidencial deri në vitin 2024 të arrijnë 14.46 ktoe. Të dhënat më të fundit tregojnë se kursimet në këto objekte janë ekuivalent me 14.22 ktoe, që tregon se objektivi pothuajse është arritur. Megjithatë, duke marrë parasysh se deri në vitin 2031 caku është që këto kursime të arrijnë 232.5 ktoe, realizimi i objektivit afatgjatë me këtë ritëm duket sfidues për t'u arritur. Në këtë sfidë ndikon edhe fakti që investimet në efikasitet janë drejtuar më shumë në ndërtesa publike sesa në ndërtesat rezidenciale. Sipas disa llogaritjeve, më shumë se 771.1 milionë euro janë investuar në ndërtesa publike krahasuar me vetëm 288.8 milionë euro në sektorin rezidencial dhe komercial.⁶⁶

Për të adresuar këtë çështje, në kuadër të FKEE-së janë ofruar kredi dhe subvencione për investime në izolim, dritare, pompa të nxehtësisë dhe sisteme të tjera që ulin konsumin e energjisë.⁶⁷ Vetëm nga thirrjet e viteve 2023 dhe 2024, gjithsej 3,875 familje kanë përfituar nga këto subvencione për efikasitet të energjisë.⁶⁸ Megjithatë, matjet tregojnë se për të arritur kursimet e energjisë të parashikuara në strategji, Qeveria e Republikës së Kosovës, së bashku me institucionet financiare, sektorin privat dhe donatorët, do të duhet të investojë rreth 322 milionë euro gjithsej, ose mesatarisht rreth 32 milionë euro në vit.⁶⁹ Këto investime përfshijnë rinovimin e ndërtesave me izolim të murit, çatisë dhe dyshemesë, zëvendësimin e dritareve të vjetra me dritare efikase energjetikisht, si dhe instalimin e pajisjeve të ngrohjes dhe

61 Sipas të dhënave nga Ministria e Ekonomisë, deri në vitin 2024 ishte parashikuar që niveli i kursimit të arrinte 3.3 ktoe, ndërsa vlerat aktuale tregojnë 21.79 ktoe kursim të energjisë në këto ndërtesa. Për arsye të mungesës së një metodologjie të saktë të matjes së kursimeve të ndërtesat e sektorit publik, këto të dhëna mbetën vetëm informacion shtesë.

62 Lidhur me përmirësimin të efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike, BERZh ka alokuar 50 milionë euro, me të cilat synohet rinovimi i rreth 400 ndërtesave publike dhe arritja e kursimeve të energjisë prej 30–50%. Në këtë projekt përfshihen edhe 12.6 milionë euro nga Qeveria e Kosovës, 7 milionë euro nga Bashkimi Evropian dhe 3 milionë euro nga Fondi Danez për Kosovën, duke e çuar vlerën totale të financimit në 86 milionë euro. European Bank for Reconstruction and Development (EBRD). [EBRD provides €50 million to boost energy efficiency in Kosovo's public buildings](#). 2025.

63 Këtu përfshihen objekte shkollë, qendra të mjekësisë familjare, qendra të sportit dhe kulturës, etj.

64 Instituti GAP. [Mbështetja e Qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve \(të ardhshme\) energjetike: gjashtëshja e ballkanit perëndimor](#).

65 Organization for Economic Co-operation and Development (OECD). [Multi-dimensional Review of the Western Balkans](#). 2022

66 Instituti GAP. [Mbështetja e Qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve \(të ardhshme\) energjetike: gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor](#). f. 6

67 Green Economic Financing Facility (GEFF). [Increasing energy efficiency in Kosovo's buildings](#).

68 Bazuar në të dhëna nga Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE).

69 Instituti GAP. [Mbështetja e Qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve \(të ardhshme\) energjetike: gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor](#). f.43

ujit të ngrohtë me efikasitet të lartë.⁷⁰ Duke marrë parasysh që sektori rezidencial është konsumatori më i madh i energjisë në vend, nevojitet intensifikim i këtyre investimeve, pasi japin rezultate të shpejta në arritjen e kursimeve të energjisë.


Sfiduese mbeten humbjet e energjisë në shpërndarje (13.7%) të cilat kufizojnë mundësinë e investimeve në efikasitetin energjetik në sektorin rezidencial. Kosova ka potencial të konsiderueshëm kurimi përmes reduktimit të humbjeve në rrjet dhe investimeve në efikasitetin energjetik të ndërtesave.⁷¹

Element i rëndësishëm i investimeve në efikasitetin të energjisë është ndikimi në nxitjen e krijimit të vendeve të reja të punës shumë më shpejt sesa masat e punësimit direkt, për shkak të intensitetit manual të nevojshëm për instalimin e pajisjeve.⁷² Llogaritjet tregojnë që me zbatimin e këtyre masave të investimeve në efikasitet, për çdo milion euro të kursyer krijohen rreth shtatë vende të reja pune.⁷³ Në Kosovë, nëse Strategjia e Energjisë 2022-2031 zbatohet sipas objektivave dhe planifikimeve, vetëm si rezultat i investimeve në efikasitetin të energjisë do të mundësohej krijimi i më shumë se katër mijë vendeve të reja të punës.⁷⁴

Objektivi specifik: Promovimi i kogjenerimit efikas dhe sistemeve efikase të ngrohjes qendrore

Si pjesë e objektivit për rritjen e efikasitetit në kuadër të Strategjisë së Energjisë 2022–2031, është parashikuar edhe rritja e kapaciteteve të kogjenerimit në NQ Termokos, si dhe rritja e numrit të konsumatorëve të lidhur me sistemet e ngrohjes qendrore në Prishtinë dhe Gjakovë. Sipas të dhënave nga ZRrE, kapaciteti i kogjenerimit të Termokos është 140 MWth, në përputhje me cakun për vitin 2024.⁷⁵ Megjithatë, sipas Ministrisë së Ekonomisë, projekti për dyfishimin e këtyre kapaciteteve ende nuk ka filluar. Ndërkohë, numri i konsumatorëve të lidhur me ngrohjen qendrore ka arritur në 26,636 (25,752 në Termokos dhe 884 në Gjakovë), duke tejkaluar cakun prej 24,560 konsumatorësh të përcaktuar në strategji, çka tregon se ky objektivi është arritur me sukses.

Figura 8. Numri i konsumatorëve të lidhur me sistemet e ngrohjes qendrore



Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE)

⁷⁰ Ibid. f.29

⁷¹ Institute for Energy Economics and Financial Analysis (IEEFA). *Beyond coal: Investing in Kosovo's energy future*. 2020

⁷² Instituti GAP. *Mbështetja e Qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve (të ardhshme) energjetike: gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor*. f.51

⁷³ Ibid. f.53

⁷⁴ Instituti GAP. *Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë*. 2025. f.17

⁷⁵ Të dhënat janë siguruar nga ZRrE përmes kërkesës për qasje në të dhëna publike.

Objektivi IV. Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut

Objektivi specifik: Forcimi i bashkëpunimit rajonal

Në kontekstin e bashkëpunimit rajonal, janë arritur disa hapa përpara drejt integritetit në mekanizmat rajonalë. Në kuadër të këtij objekti, është arritur edhe liberalizimi i tregut të energjisë, duke filluar nga qershori i vitit 2025.⁷⁶ Po ashtu, integrimi me tregun e Shqipërisë është përcaktuar si një objektiv me prioritet të lartë dhe, si rrjedhojë, nga data 1 shkurt 2024 ka filluar blerja e energjisë elektrike përmes bursës shqiptare të energjisë, e quajtur ALPEX, e bashkëthemeluar nga KOSTT dhe OST.^{77,78} Megjithatë, performanca e tregtimit përmes bursës është e limituar, pasi që vëllimi i energjisë së tregtuar ende mbetet i vogël. Sipas ZRrE, tregtimi vazhdon të dominohet nga kontratat bilaterale të cilat janë kryesisht afatgjata ku përveç furnizimit mbulohen edhe humbjet në rrjet dhe kjo lë pak hapësirë për tregtim përmes bursës.⁷⁹

Po ashtu, sipas të dhënave të fundit, kapaciteti ndërkufitar mbetet 22–24% për eksport dhe 24–26% për import, ndërkohë që ishte parashikuar të arrinte së paku 28–30% në secilin drejtim deri në vitin 2024. Kjo për shkak se gjatë viteve të fundit nuk ka pasur implementim të ndonjë linje të re ndërkufitare. Objektivi afatgjatë në kuadër të bashkëpunimit me vendet e tjera është që deri në vitin 2031, Kosova të bëhet pjesë e tregut pan-evropian të energjisë, ku energjia do të rregullohet dhe tregtohet sipas rregullave të përbashkëta të BE-së dhe rajonit.⁸⁰

Objektivi specifik: Aftësimi në fushat e lidhura me energjinë dhe përfshirja e grave

Një element i rëndësishëm i tranzicionit energjetik është zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, veçanërisht përmes aftësimit të rinjve në fushat e energjisë dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në këtë sektor. Arsimi dhe kualifikimet luajnë rol kyç në realizimin e objektivave klimatike. Studimet tregojnë se në sektorin e energjisë solare vetëm gjysma e pozitave të punës kërkojnë arsim universitar, çka nënkupton se një numër i madh i vendeve të punës mund të plotësohet nga persona që kanë përfunduar arsimin profesional. Megjithatë, nevojitet më shumë mbështetje financiare dhe teknike për themelimin e qendrave që fokusohen në aftësimin profesional për sektorin e energjisë.⁸¹

Ndonëse dokumenti i Strategjisë së Energjisë 2022-2031 nuk përcakton synime specifike lidhur me numrin e të diplomuarve, dokumenti i Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë synon që deri në vitin 2031, numri i të diplomuarve të arrijë në 230 persona. Vlera bazë e vitit 2021 tregon që gjithsej në fushat që lidhen me tranzicion energjetik kanë diplomuar gjithsej 169 persona. Sipas të dhënave për vitin shkollor 2024/25, numri është rritur në 384 persona, përfshi këtu të diplomuarit nga shkollat e mesme profesionale, nga universitetet dhe akademja e KEDS.^{82, 83}

76 Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). Njoftim Publik mbi Liberalizimin e Tregut të Energjisë në Kosovë.

77 Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031

78 OST ka në disponim 57.25% të aksioneve dhe KOSTT disponon 42.75% të aksioneve. KOSTT. Plani i Biznesit për vitin 2025.

79 Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRrE). Raporti vjetor 2025.

80 Ibid. f.19

81 Instituti GAP. Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë. 2025. f.17

82 Nga ky numër, 127 janë të diplomuar nga shkolla të mesme profesionale, 215 nga Akademia e KEDS, 28 nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe 14 nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM).

83 Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Ekonomisë (Departamenti i Energjisë).

Gjithashtu, fuqizimi i punësimit të grave në sektorin e energjisë është një indikator i rëndësishëm i përcaktuar në Strategjinë e Energjisë. Përqindja e grave të punësuar në këtë sektor në vitin 2021 ishte 9%, ndërsa të dhënat për vitin 2025 tregojnë se kjo përqindje është rritur në 20%. Kjo nënkupton se caku për vitin 2024, që parashihte cakun 11% të punësimit të grave, është tejkaluar, duke e afruar sektorin më shumë drejt objektivit për vitin 2031.⁸⁴

Figura 9. Gratë e punësuar në sektorin e energjisë (si përqindje)



Burimi: Ministria e Ekonomisë

Në këtë rritje të punësimit dhe përfaqësimit të grave në sektorin e energjisë kanë ndikuar iniciativa konkrete që kanë hapur më shumë mundësi për gratë, si projekti “Energji për Barazi” i MCC/MCA Kosova, i cili synon fuqizimin e grave përmes praktikave të barabarta gjinore në kompani, rrjetëzimit, mentorimit, trajnimeve dhe mbështetjes me asistencë teknike dhe grante të vogla për punëdhënësit.⁸⁵ Po ashtu, Solarit Academy, e mbështetur nga Helvetas Kosova përmes projektit EYE, synon të fuqizojë gratë në sektorin e energjisë së ripërtëritshme duke ofruar trajnime të specializuara dhe mentorim për t’i ndihmuar të hyjnë dhe të avancojnë në industrinë e energjisë.⁸⁶ Gjithashtu, rrjeti “Gratë në Energji dhe Miniera” (WEM),⁸⁷ në kuadër të Odës Amerikane në Kosovë, shërben si një platformë për avokim, zhvillim profesional dhe rrjetëzim. Të gjitha këto iniciativa së bashku kanë ndihmuar gratë të hyjnë dhe të avancojnë në një sektor tradicionalisht të dominuar nga burrat.

⁸⁴ Ibid.

⁸⁵ Millenium Challenge Account- Kosovo. [Minutes of the 9th Board of Directors Meeting](#). 2024

⁸⁶ Helvetas. [Empowering Women in Kosovo's Solar Panel Industry](#). 2025

⁸⁷ American Chamber of Commerce (AmCham). Energy and Mining Committee.

Objektivi V. Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve

Strategjia për Energji 2022-2031 kishte parashikuar krijimin e dyskemave mbështetëse për konsumatorët në nevojë deri në vitin 2024 dhe katër skema deri në vitin 2031. Aktualisht, ky objektivi është përmbushur, pasi në funksion janë tre skema kryesore: subvencionimi i faturave të energjisë elektrike për familjet me të ardhura të ulëta, mbështetja për investime në efikasitet energjetik si izolimi dhe pajisjet efikase, si dhe një program emergjent për subvencione shtesë gjatë krizës energjetike.⁸⁸ Mirëpo, mungon një program i strukturuar për varfërinë energjetike që targeton, sipas një metodologjie të qartë ligjore, grupet e cënueshme në këtë aspekt.

Objektivi specifik: Fuqizimi i konsumatorëve

Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022–2031 parasheh rritjen e numrit të fushatave vetëdijësuese dhe informuese për energjinë nga 6 në vitin bazë (2021) në të paktën 9 fushata në vit. Sipas të dhënave me të fundit, vetëm gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 17 fushata duke tejkaluar si objektivin e parashikuar vjetor. Fushatat për efikasitet të energjisë kanë qenë kryesisht të organizuara nga Ministria e Ekonomisë dhe FKEE, me mbështetje të Qeverisë së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Këto fushata kanë përfshirë mesazhe për kursim energjie gjatë krizës, si dhe informim për subvencione për izolim të shtëpive dhe pajisje efikase, të shpërndara përmes mediave dhe rrjeteve sociale. Qëllimi kryesor ka qenë ulja e konsumit të energjisë dhe rritja e ndërgjegjësimin të qytetarët për përdorim më efikas të saj.

Objektivi specifik: Ruajtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit

Krahasuar me objektivat për vitin 2024, emetimet nga termocentralet në Kosovë në disa raste tejkalojnë kufijtë e synuar, veçanërisht për pluhurin dhe NO_x, sidomos në TC Kosova B, ndërsa emetimet e SO₂ zakonisht mbeten brenda kufijve të lejuar. Edhe në TC Kosova A ka tejkalime, më të theksuara në njësinë A3, ndërsa njësitë A4 dhe A5 janë më afër standardeve të përcaktuara. Këto mospërputhje lidhen kryesisht me vonesat në realizimin e projekteve dhe renovimin e njësive ekzistuese, duke ndikuar edhe në mosarritjen e objektivave për reduktimin e CO₂. Projektet për reduktimin e SO_x pritet të realizohen deri në vitin 2028 (shih Tabelën 1 në Shtojcë).

⁸⁸ Ministria e Ekonomisë. *200 Families in Need to Benefit from Energy-Efficiency Measures*. 2025

Mekanizmi i rregullimit të kufirit të karbonit (CBAM)

Mekanizmi i Rregullimit të Kufirit për Karbonin (ang. CBAM) është një politikë e BE-së që vendos një kosto karboni për disa mallra të importuara bazuar në emetimet e tyre gjatë prodhimit, duke siguruar kështu që importet të përballen me çmime karboni të ngjashme me ato të mallrave të prodhuara në BE dhe duke ndihmuar në parandalimin e rrjedhjes së karbonit.⁸⁹ Sektorët fillestarë të mbuluar nga CBAM përfshijnë mallrat me intensitet të lartë karboni që janë më të ndjeshëm ndaj rrjedhjes së karbonit, duke përfshirë: energjinë elektrike, hekurin dhe çelikun, aluminin, cementin, plehrat azotike dhe hidrogjenin.⁹⁰

Ky mekanizëm është pjesë e ligjit të ri të energjisë së BE-së, me qëllim kryesor reduktimin e emetimeve të karbonit me të paktën 55% krahasuar me vitin 1990. Taksa e karbonit nuk përjashton asnjë vend, përveç nëse shteti është pjesë e Sistemit Evropian për Tregtimin e Emetimeve (EU ETS⁹¹), apo ka një rregullore të brendshme që përcakton çmimin e karbonit për sektorët e lartpërmendur, të cilat më pas zbriten nga tarifa e BE-së. Çmimi i karbonit mund të ndryshojë çdo ditë dhe, sipas të dhënave më të fundit, një ton karbon kushton rreth 66 euro për ton.⁹²

Strategjia e Energjisë së Kosovës e konsideron CBAM si një objektiv me rëndësi të lartë dhe sugjeron vendosjen e një skeme kombëtare të tregtimit të karbonit, me rritje graduale të çmimit minimal, që të përputhet me çmimet e EU ETS deri në vitin 2030.⁹³ Për këtë çështje janë paraqitur disa skenarë modelimi për çmimin e karbonit: i pari parashikon rritje graduale deri në 14% në vitin 2025 dhe më pas rritje lineare deri në 2031, pa CBAM; i dyti fillon me 15% në 2025 dhe rritet gradualisht deri në 2030; ndërsa i treti, më ambicioz, nis me 15% në 2025, arrin 35% në 2030 dhe 100% në 2035, me variante me dhe pa CBAM.⁹⁴ Të tre skenarët shërbejnë për analiza të ndikimit në sektorin energjetik dhe nuk përbëjnë politika detyruese në Kosovë.

Tabela 2. Skenarët e modelimit të çmimit të karbonit sipas Strategjisë së Energjisë 2022-2031

	Rritja e çmimeve	Trajektorja e rritjes	CBAM
Skenari I	14% në vitin 2025, pastaj rritje lineare	Rritje graduale deri në 2031	Nuk parashihet asnjë CBAM
Skenari II	15% në vitin 2025, pastaj rritje lineare	Rritje graduale deri në 2030	Nuk specifikohet
Skenari III	15% në 2025 35% në 2030 100% në 2035	Rritje e përshpejtuar me faza	Me dhe pa CBAM

Synimi kryesor i skemës së taksës së karbonit bazuar në dokumentin e strategjisë së energjisë është të reduktohen emetimet dhe të shmangen pagesat e CBAM, përmes mbledhjes së të hyrave nga prodhuesit e energjisë dhe mbajtjes së tyre brenda vendit, si dhe grumbullimit në një Fond të Tranzicionit të Drejtë. Përdorimi i

⁸⁹ Energy Community, [Carbon Border Adjustment Mechanism](#). Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#).

⁹⁰ Carbon Market Watch, [EU Carbon Border Adjustment Mechanism \(CBAM\)](#). 2024

⁹¹ European Commission, EU ETS, [EU Emissions Trading System](#).

⁹² Abnet K., Twidale S, [EU Carbon Prices Slide After Lawmakers Signal Market Intervention](#). 2026

⁹³ Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#)

⁹⁴ Për më shumë detaje, shih tabelën 1 në faqe 9 të dokumentit të Strategjisë së Energjisë 2022-2031.

këtij Fondi do të përcaktohet më vonë, dhe mund të jetë i dedikuar për promovimin e energjisë të ripërtëritshme, aftësimin dhe riaftësimin e fuqisë punëtore dhe mbështetjen e konsumatorëve në nevojë.⁹⁵

Sidoqoftë, përkundër objektivave të parashikuara, deri më tani, sipas Ministrisë së Ekonomisë, nuk ka pasur ndonjë zhvillim për zbatimin gradual të çmimit të karbonit në vend.⁹⁶ Në situatë të ngjashme janë edhe vendet tjera në rajonin e Ballkanit Perëndimor.⁹⁷ Mali i Zi është i vetmi vend me një sistem funksional, pasi ka zbatuar një sistem të tregtimit të emetimeve (ETS) që nga viti 2020, megjithëse me çmime relativisht të ulëta të karbonit. Në anën tjetër, Bosnja dhe Hercegovina po përgatit një ETS që pritet të fillojë rreth viteve 2026–2027. Shqipëria planifikon një model hibrid (taksë karboni dhe ETS) që nga 2027–2028. Serbia synon të zbatojë një taksë karboni duke filluar nga viti 2027, me kalim të mëvonshëm në një sistem ETS. Maqedonia e Veriut planifikon të vendosë një taksë karboni nga viti 2028. Në përgjithësi, rajoni po përafrohet me politikat klimatike të BE-së, por mbetet kryesisht në fazën e planifikimit ose zbatimit fillestar, me vetëm nivele të kufizuara të çmimit të karbonit në praktikë.

Sipas të dhënave nga Dogana e Kosovës, rreth 34% e eksporteve të Kosovës gjatë vitit 2025 shkojnë drejt shteteve të BE-së, ndërsa 11.8% prej tyre (me vlerë rreth 37 milionë euro) janë produkte me intensitet të lartë karboni.⁹⁸ Produktet e hekurit dhe çelikut pritet të ndikohen më shumë nga taksa e karbonit, pasi që përbëjnë rreth 72% të të gjitha eksporteve të Kosovës të cilat ndikohen nga CBAM, ndjekur nga alumini, sektor i cili përfaqëson afërsisht 27% të vlerës totale të eksportit nga Kosova drejt shteteve të BE. Kosto e eksportit të produkteve nga prodhuesit të cilët eksportojnë produkte nga këta sektorë do të rritet, pas detyrimit për të mbuluar edhe taksën shtesë të karbonit.

Vendet e BE-së nga janari 2026 kanë filluar zbatimin e CBAM.⁹⁹ Në kuadër të sistemit EU ETS, disa sektorë marrin leje të emetimit falas (ang. Free Allocation of Allowances) për të adresuar rrezikun e rrjedhjes së karbonit. Si fillim, vetëm një pjesë e vogël e koston e lejeve falas të EU ETS do të zëvendësohet nga CBAM, duke filluar me 2.5%. Kjo përqindje do të rritet gradualisht çdo vit sipas skemës së përcaktuar, duke arritur 48.5% në vitin 2030 dhe duke vazhduar rritjen deri në 100% në vitin 2034.¹⁰⁰ Në këtë vit, të gjitha lejet falas do zëvendësohen, dhe importuesit do të paguajnë plotësisht për emetimet e karbonit të mallrave të tyre. Ky proces i gradualitetit siguron një tranzicion të qetë për industrinë dhe importuesit.¹⁰¹

Tabela 3. Pagesa e CBAM sipas lejeve të EU ETS

Viti	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034
Pagesa CBAM (%)	2.50%	5.00%	10.00%	22.50%	48.50%	61.00%	73.50%	86.00%	100%

Burimi: Parlamenti Evropian

⁹⁵ Ibid.

⁹⁶ Ministria e Ekonomisë. Raporti i Progresit për Periudhën Janar- Qershor 2025. 2025

⁹⁷ Energy Community. CBAM- Readiness Tracker. Table 11, p.48, 2025

⁹⁸ Dogana e Kosovës. Bilanci tregtar janar- dhjetor 2025.

⁹⁹ European Union. CBAM successfully entered into force on 1 January 2026.

¹⁰⁰ European Parliament. Legislative Train. A European Green Deal, f. 2. 2025

¹⁰¹ Ibid.

Nëse qeveritë e Ballkanit Perëndimor do të kishin filluar përgatitjet për CBAM më herët, në vend që të lejonin BE-në të përfitonte nga eksportet e tyre të energjisë elektrike, ato do të kishin mundur të gjeneronin të ardhura për tranzicionin e tyre energjetik duke vendosur vetë çmimin e karbonit në nivel vendor.¹⁰² Sipas disa llogaritjeve, bazuar në emetimet mesatare vjetore prej 55.6 milionë ton CO₂ gjatë periudhës 2017–2022 në vendet e rajonit me intensitet të lartë karboni, një çmim prej 75 euro për ton mund të gjenerojë deri në 4.2 miliardë euro në vit për të mbështetur një tranzicion të drejtë dhe të qëndrueshëm energjetik.¹⁰³

Në kontekstin e tranzicionit energjetik, një rol të rëndësishëm kanë të ashtuquajturat garanci të origjinës (GOs). Ato janë certifikata elektronike që dëshmojnë se një sasi e caktuar e energjisë elektrike është prodhuar nga burime të ripërtëritshme.¹⁰⁴ Çdo garanci e origjinës përfaqëson 1 MWh energji të prodhuar dhe nuk mund të lëshohet më shumë se një certifikatë për çdo njësi të energjisë; ajo mbetet e vlefshme për 12 muaj nga fundi i periudhës së prodhimit.¹⁰⁵ Këto certifikata rrisin transparencën në tregun e energjisë dhe u mundësojnë konsumatorëve dhe kompanive të vërtetojnë se energjia që përdorin vjen nga burime të pastra.¹⁰⁶

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRrE) është përcaktuar si organi lëshues përgjegjës për lëshimin dhe menaxhimin e Garancive të Origjinës për energjinë elektrike nga burime të ripërtëritshme të prodhuar në Kosovë.¹⁰⁷ Në nëntor 2025, Kosova u bë anëtare e plotë e Asociacionit të Trupave Lëshues (AIB), i cili menaxhon Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS).¹⁰⁸ Në kuadër të Komunitetit të Energjisë është zhvilluar një sistem rajonal për Garancitë e Origjinës, i cili përfshin edhe Kosovën. Ky sistem synon harmonizimin e rregullave dhe krijimin e regjistrave elektronikë për lëshimin dhe menaxhimin e këtyre certifikatave. Megjithatë, aktualisht Garancitë e Origjinës të lëshuara nga vendet e Komunitetit të Energjisë ende nuk njihen automatikisht në tregun e BE-së.¹⁰⁹ Kjo nënkupton që edhe certifikatat e lëshuara nga Kosova nuk njihen nga shtetet e BE-së.

¹⁰² Bankwatch Network (CEE). A Perfect Storm. [The Western Balkans power sector in the time of CBAM](#). 2025

¹⁰³ Ibid.

¹⁰⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës. [On the promotion of the use of renewable energy sources](#). Law No. 08/L-258. f.4.

¹⁰⁵ Ibid., f.42.

¹⁰⁶ Balkan Green Foundation. Green and Competitive. Leveraging Guarantees of Origin for Export Growth and Energy Transition in Kosovo. f.13,21.

¹⁰⁷ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE). [Rules on Guarantees of Origin](#). 2025

¹⁰⁸ Ibid. [Press Release](#). 2025

¹⁰⁹ Energy Community. Renewable Energy. [Guarantees of Origin](#).

Sfidat në implementimin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031

Zbatimi i Strategjisë së Energjisë 2022–2031 në Kosovë ka shënuar disa përparime të rëndësishme, veçanërisht në përmirësimin e besueshmërisë së furnizimit, uljen e humbjeve në rrjet dhe rritjen e kursimeve të energjisë. Këto rezultate janë arritur falë investimeve në modernizimin e rrjetit, masave për eficiencë energjetike dhe mbështetjes për konsumatorët. Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, zbatimi i strategjisë përballlet me një sërë pengesash strukturore dhe institucionale që kanë ngadalësuar progresin, sidomos në komponentët kyç të tranzicionit energjetik.

Një ndër sfidat kryesore është zhvillimi i ngadaltë i kapaciteteve gjeneruese nga BRE-të. Edhe pse janë ndërmarrë hapa si organizimi i ankandeve për energji solare dhe të erës, kapacitetet aktuale mbeten dukshëm nën objektivat e përcaktuara. Disa nga arsyt kryesore për këtë përfshijnë procedurat administrative të ngadalshme dhe të zgjatura (si aplikimet për leje), kapacitetet e kufizuara të rrjetit për integrimin e BRE-ve të reja, çështjet pronësore, mungesa e koordinimit në mes të institucioneve, si dhe vështirësitë në financim. Këto barrierë kanë bërë që Kosova të mbetet prapa vendeve të rajonit në zhvillimin e energjisë së pastër, duke e vështirësuar arritjen e objektivave afatgjata për dekarbonizim. Po ashtu, mungesa e zhvillimit në sektorin e ngrohjes qendrore dhe integrimin e BRE-ve në këtë sektor paraqet një sfidë të vazhdueshme. Kapacitetet e ngrohjes me burime të pastra kanë mbetur të pandryshuara, ndërsa shumica e amvisërive vazhdojnë të mbështeten në forma joefikase të ngrohjes. Kjo tregon për mungesë të investimeve dhe për pengesa institucionale dhe rregullative që kufizojnë zhvillimin e këtij segmenti.

Është e rëndësishme të theksohet se arritja e disa cazeve të përcaktuara në përcaktuara në dokumentin e Strategjisë së Energjisë 2022-2031 nuk nënkupton domosdoshmërisht progres substancial në transformimin e sektorit energjetik. Në disa raste, indikatorët mund të përmbushen ose tejkalohen përmes ndërhyrjeve të kufizuara ose të fragmentuara, pa reflektuar ndryshime strukturore në sistem. Për shembull, rritja e numrit të prosumatorëve, ndonëse pozitive në aspektin e decentralizimit të prodhimit, nuk nënkupton automatikisht një tranzicion të qëndrueshëm të sistemit energjetik në tërësi. Në mënyrë të ngjashme, tejkalimi i numrit të fushatave vetëdijësuese nuk garanton domosdoshmërisht përmirësim të matshëm në sjelljen e konsumatorëve ndaj kursimeve të energjisë. Prandaj, është e rëndësishme që vlerësimi i progresit në këtë raport të mos bazohet vetëm në përmbushjen e indikatorëve, por edhe në analizën e ndikimit real të tyre në funksionimin e sektorit të energjisë në përgjithësi.

Një tjetër sfidë e rëndësishme është mungesa e progresit në vendosjen e mekanizmave të çmimit të karbonit. Edhe pse strategjia e konsideron këtë si një element kyç për përafrimin me politikat e BE-së dhe për përballimin e mekanizmave si CBAM, deri më tani nuk ka pasur hapa konkretë në këtë drejtim. Kjo e vendos Kosovën në një pozitë të pafavorshme krahasuar me vendet e rajonit, të cilat tashmë kanë filluar të zbatojnë ose planifikojnë skema të tilla, dhe rrit rrezikun e kostove shtesë për eksportuesit vendorë. Në një nivel më të thellë, kjo mungesë progresi reflekton jo vetëm vonesa në implementim, por edhe mungesë të një qasjeje të integruar ndaj tranzicionit energjetik. Në të njëjtën kohë, mospërputhjet ndërmjet objektivave strategjike dhe masave zbatuese, përfshirë mungesën e vendosjes së një takse të brendshme të karbonit, ritmin e ngadalshëm të zhvillimit të burimeve

të ripërtëritshme dhe vonesat në investime strukturore, sugjerojnë kufizime më të thella institucionale në aftësinë për të menaxhuar një tranzicion të drejtë dhe afatgjatë.

Për më tepër, Strategjia e Energjisë 2022–2031 nuk e mbulon tërë ekonominë e vendit, pasi sektorë si industria dhe transporti nuk janë të përfshirë në këtë strategji. Të dy këta sektorë kontribuojnë ndjeshëm në ndryshimet klimatike, si burime të larta të emetimeve¹¹⁰ dhe si konsumatorë të mëdhenj të energjisë.¹¹¹ Si të tillë, ata janë kyç në hartimin e politikave energjetike, sikur në rastin e politikave të gjelbra industriale të cilat sipas evidencës ndikojnë në transport të qëndrueshëm, reduktojnë ndotjen dhe rrisin konkurrueshmërinë.¹¹² Në Kosovë, këta sektorë trajtohen përmes kornizave të veçanta politike, më saktësisht përmes zhvillimit të strategjive kombëtare që adresojnë planet afatgjata për këta sektorë. Për më tepër, çështja e dekarbonizimit të tyre integrohet në Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025–2030.¹¹³ Megjithatë, ka përqëndrim të pamjaftueshëm veçanërisht në sektorin e transportit, sipas BERZh. Transporti publik, sidomos hekurudhat, është identifikuar si fushë me potencial të rëndësishëm për mbështetjen e tranzicionit të gjelbër, por zhvillimi i tij ka përparuar ngadalë, duke kufizuar kontributin e mundshëm në uljen e emetimeve dhe në reduktimin e varësisë nga energjia.

Sfidë mbeten vonesat në realizimin e projekteve investive, veçanërisht në rehabilitimin dhe modernizimin e termocentraleve ekzistuese. Projektet për njësitë B1 dhe B2 të TC Kosova B dhe për njësinë A3 të TC Kosova A nuk kanë filluar sipas afateve të planifikuara, kryesisht për shkak të problemeve kontraktuale, përfshirë falimentimin e operatorëve ekonomikë dhe kërkesat për kosto shtesë. Këto vonesa jo vetëm që rrezikojnë sigurinë e furnizimit, por ndikojnë drejtpërdrejt edhe në mosarritjen e standardeve mjedisore dhe reduktimin e emetimeve, duke e bërë tranzicionin më të ngadaltë dhe më të kushtueshëm.

Një vështirësi tjetër që vërehet në Strategjinë e Energjisë 2022–2031 ka të bëjë me nevojat financiare të strategjisë, nivelin e reflektimit të tyre në buxhet dhe kapacitetin për zbatim. Dokumenti përmend shifra të larta investimesh të planifikuara si kombinim i burimeve të financimit nga niveli publik, privat dhe granteve nga donatorët, të cilat për t'u implementuar sipas strategjisë, tejkalojnë 3 miliardë euro. Për ilustrim, vetëm për rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese gjeneruese janë parashikuar rreth 390 milionë euro dhe rreth 350 milionë euro tjera për eficiencë energjetike.

Tabela 4. Shpenzimet për zbatimin e komponentëve kryesorë të Strategjisë së Energjisë 2022–2031

	Kosto (milionë euro)	Burimet e financimit
Rehabilitimi dhe ulja e ndikimit mjedisor e kapaciteteve gjeneruese ekzistuese	390	Publike
Kapacitetet e reja gjeneruese nga BRE-të	1,300	Private, publike, grante

¹¹⁰ European Commission. [National Energy and Climate Plans](#).

¹¹¹ United Nations. [Sustainable Development Goals](#).

¹¹² Instituti GAP. [Një kornizë për politika industriale të gjelbra në Ballkanin Perëndimor](#). 2025

¹¹³ Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031](#)

	Kosto (milionë euro)	Burimet e financimit
Kapacitetet e reja (të përbashkëta) në vendet fqinje	200	Publike, grante
Kapacitetet akumuluese (bateri)	200	Publike, grante
Investimet në rrjet të transmisionit	90	Publike, grante
Investimet në rrjet të shpërndarjes	230	Private
Investimet në efikasitet të energjisë	350	Publike, private, grante
Investimet në sisteme të ngrohjes	100-200	Publike, grante
Mbrojtja dhe furnizimi i konsumatorëve me përqendrim të veçantë tek konsumatorët në nevojë	100-200	Publike, grante

Burimi: Ministria e Ekonomisë

Më konkretisht, rehabilitimi i njësive ekzistuese energjetike paraqet një ndër komponentët më të kushtueshëm të strategjisë për buxhetin publik, posaçërisht për KEK-un. Sipas Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2026-2028, për njësinë Kosova B1 parashihen 88 milionë euro (49.5 milionë nga KEK dhe 38.5 milionë nga grantet e BE-së), ndërsa për Kosova B2 rreth 38.5 milionë euro, të financuara kryesisht nga grantet e BE-së. Ndërkaq, rehabilitimi i njësisë A3 të Kosova A pritët të kushtojë rreth 137 milionë euro dhe të financohet nga KEK. Vetëm për vitet 2026 dhe 2027, buxheti për këto investime parashikohet të arrijë përkatësisht 108 dhe 156 milionë euro. Megjithatë, sipas KEK, pavarësisht performancës së qëndrueshme financiare dhe të hyrave të parashikuara prej rreth 240 milionë euro për vitin 2026, realizimi i investimeve kapitale mbetet sfidues.¹¹⁴ Në anën tjetër, sektori i efikasitetit të energjisë kërkon investime mesatare vjetore mbi 30 milionë euro për të arritur objektivat afatgjata.¹¹⁵ Në kuadër të masave të BE-së ndaj Kosovës, sektori i dytë më i prekur ishte ai i energjisë, me 114.4 milionë euro fonde të pezulluara.¹¹⁶ Vetëm nga fondet IPA II, ndër projektet e pezulluara përfshihet një projekt kyç për sektorin e energjisë i cili është ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore (25 milionë euro).¹¹⁷ Këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e implementimit të projekteve, duke shkaktuar vonesa në financimin dhe zbatimin e masave të planifikuara për efikasitet energjetike. Kombinimi i këtyre sfidave, së bashku me kapacitetet dhe mekanizmat për menaxhimin në kohë të fondeve, nënkupton më tej vonesa në realizimin e objektivave strategjike.

Krahas masave dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Energjisë 2022–2031, në diskursin publik janë paraqitur edhe zotime për zhvillimin e një centrali me gaz, përkatësisht iniciativa që lidhen me gazifikimin e qymyrit si alternativë ndaj qymyrit. Megjithatë, një investim i tillë nuk parashikohet në dokumentin e strategjisë, çka krijon mospërputhje ndërmjet dokumentit strategjik dhe premtimeve apo planeve të reja politike. Në këtë kontekst, organizatat e shoqërisë civile kanë theksuar në mënyrë të vazhdueshme nevojën për shmangien e investimeve të reja në kapacitete me lëndë djegëse fosile, duke argumentuar se ato rrezikojnë të ngadalësojnë tranzicionin drejt burimeve të ripërtëritshme dhe objektivave të dekarbonizimit.

¹¹⁴ Korporata Energjetike e Kosovës (KEK). [Plani i Buxhetit për vitin 2026](#). 2025

¹¹⁵ Instituti GAP. [Mbështetja e qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve \(të ardhshme\) energjetike: Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor](#). 2024

¹¹⁶ Instituti GAP. [Ndikimi financiar i masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës](#). 2025

¹¹⁷ Ibid.

Përfundim dhe rekomandime

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022–2031 synon transformimin e sektorit energjetik drejt një sistemi më të qëndrueshëm, të sigurt dhe më të pastër, në përputhje me obligimet ndaj Komunitetit të Energjisë dhe orientimin drejt politikave të BE-së. Raporti vlerësues për periudhën e caqeve afatshkurta tregon se ka pasur përmirësime të dukshme në besueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit si rezultat i modernizimit të rrjetit dhe menaxhimit më të mirë, por mbeten vonesa të rëndësishme në rinovimin e kapaciteteve gjeneruese që mund të ndikojnë sigurinë e furnizimit dhe standardet mjedisore, ndërkohë që progresi në dekarbonizim dhe zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme është më i ngadalshëm, megjithëse vërehen hapa pozitivë drejt rritjes së vetëprodhimit dhe nxitjes së projekteve të reja. Në funksionimin e tregut dhe bashkëpunimin rajonal janë ndërmarrë disa hapa, por mbeten sfida strukturore të lidhura me përgatitjen ndaj ndikimit të CBAM dhe mungesën e mekanizmave vendorë për çmimin e karbonit.

Gjetjet e këtij raporti po ashtu tregojnë se sfidat në sektorin e energjisë nuk lidhen vetëm me zbatimin e masave të parashikuara, por në disa raste edhe me vetë dizajnin dhe supozimet mbi të cilat është ndërtuar Strategjia e Energjisë 2022–2031. Në këtë drejtim, përveç përshejtimit të implementimit të projekteve dhe reformave të caktuara, mund të jetë e nevojshme edhe një rishikim i pjesshëm i dokumentit, me qëllim përafrimin e saj me zhvillimet aktuale të tregut energjetik dhe kapaciteteve reale të vendit.

Krahasimi rajonal është përfshirë në këtë raport për disa objektiva meqë është e rëndësishme të kuptohen dallimet dhe ngjashmëritë në mënyrën se si vendet e Ballkanit Perëndimor i trajtojnë politikat energjetike dhe klimatike. Ndër vendet e rajonit, Serbia paraqet nivelin më të lartë të integritetit të sektorit industrial brenda strategjisë energjetike, pasi industria trajtohet drejtpërdrejt si konsumator kyç dhe si pjesë e politikave të efikasitetit dhe dekarbonizimit.¹¹⁸ Në të kundërt, në Shqipëri strategjitë energjetike mbeten më të fokusuar në sektorin e furnizimit me energji, ndërsa transporti dhe industria trajtohen në dokumente të ndara sektoriale.¹¹⁹ Një situatë e përafërt vërehet në Maqedoninë e Veriut, ku strategjia energjetike nuk i integron plotësisht këta sektorë, por një nivel më i lartë i koordinimit arrihet përmes Planeve Kombëtare për Energji dhe Klimë (NECP), të cilat përfshijnë masa të drejtpërdrejta për industrinë dhe transportin.¹²⁰ Një qasje e ngjashme vërehet edhe në Malin e Zi.¹²¹ Kjo tregon që dallimet ndërmjet këtyre vendeve nuk qëndrojnë vetëm në përmbajtjen e strategjive energjetike, por edhe në shkallën e integritetit institucional dhe ndërsektorial të politikave energjetike dhe klimatike.

Bazuar në gjetjet e përmendura më lartë, ky raport ka disa rekomandime specifike:

- Për të forcuar më tej besueshmërinë e sistemit, Kosova duhet të priorizojë rehabilitimin dhe modernizimin në kohë të kapaciteteve ekzistuese gjeneruese, veçanërisht TC Kosova A dhe B, të cilat sipas strategjisë do të duhej të përfundonin deri në 2024. Këtu është e rëndësishme të adresohen pengesat kontraktuale me operatorët ekonomikë si dhe mbikëqyrja e projekteve. Në të njëjtën kohë, investimet në automatizimin e rrjetit, teknologjitë moderne dhe mirëmbajtjet parandaluese duhet të vazhdojnë për të ruajtur përmirësimet në treguesit SAIDI dhe SAIFI.

¹¹⁸ Ministry of Mining and Energy. [Energy Sector Development Strategy of the Republic of Serbia up to 2040 with Projections up to 2050](#).

¹¹⁹ USAID. [Energy Strategy for Albania. Enhancing Capacity for Low Emission Development Strategies \(EC-LEDS\)](#). 2018

¹²⁰ Odysee-Mure. [North Macedonia Profile](#).

¹²¹ UN Environment Programme. [Energy Development Strategy of Montenegro until 2030](#). 2014

- Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të BRE-ve dhe për të afruar realizimin e objektivës afatgjatë që deri në 2031 ky kapacitet të arrijë në minimum 35% të konsumit total, rekomandohet krijimi i një mekanizmi 'one-stop shop', ose nëse veç ekzistojnë mekanizma, të funksionalizohen këto ekzistueset për lejet dhe dokumentacionin si dhe për të shmangur vonesat procedurale dhe burokratike. Në rastin e ankandeve, është e rëndësishme që kërkesat të mos ndryshohen gjatë procedurave dhe të bëhet përafrimi me metodologji të shteteve të rajonit në mënyrë që kushtet të jenë më të favorshme për investitorët.
- Identifikimi i zonave prioritare për investime duhet të bazohet në një analizë të detajuar të potencialit ekonomik, energjetik dhe infrastrukturor të vendit, duke marrë parasysh kërkesën aktuale dhe të ardhshme për energji, kapacitetin e rrjetit dhe mundësitë për integrim të burimeve të ripërtëritshme. Këto zona duhet të përcaktohen në mënyrë strategjike, duke përfshirë rajonet me potencial të lartë për energji solare, si dhe hapësirat ku investimet në rrjet dhe infrastrukturë mund të sjellin ndikim më të madh ekonomik dhe social. Një qasje e tillë do të mundësonte orientim më efikas të investimeve publike dhe private, si dhe përshtetshmëri të tranzicionit energjetik.
- Për t'u përafruar me politikat klimatike të BE-së dhe për të zbutur ndikimet e CBAM, Kosova duhet të fillojë gradualisht vendosjen e një çmimi të karbonit përmes dizajnit të një skeme të veçantë, përcaktimit të institucionit përgjegjës dhe ndërtimit të një sistemi të besueshëm për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të emetimeve. Paralelisht, duhet të hartohet një plan i posaçëm për CBAM që identifikon sektorët e prekur, raporton emetimet dhe mbështet bizneset eksportuese në përshtatjen me kërkesat e BE-së. Gjithashtu, rekomandohet krijimi i një fondi të dedikuar për tranzicionin energjetik nga të hyrat e mbledhura nga taksa e karbonit në vend, i cili do të financojë energjinë e ripërtëritshme, eficiencën energjetike, modernizimin e rrjetit dhe aftësimin e fuqisë punëtore. Në të njëjtën kohë, Kosova duhet të harmonizohet me tregun e BE-së për përdorimin e Garancive të Origjinës.
- Për të përmirësuar mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të krijojë një program të varfërisë së energjisë, duke targetuar më saktë skemat mbështetëse për familjet në nevojë, dhe duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe ndikim më të madh. Kjo kërkon forcimin e identifikimit të kategorive të cënueshme dhe përshtatjen e ndihmës sipas nivelit të varfërisë energjetike. Po ashtu, duhet të rritet qasja në programet e eficiencës së energjisë, përfshirë izolimin e ndërtesave, modernizimin e sistemeve të ngrohjes dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme në amvisëri, të kombinuara me masa të drejtpërdrejta financiare për familjet më të cënueshme. Këtu përfshihet rritja e financimit përmes Fondit të Eficiencës së Energjisë dhe rrjedhimisht rritja e mbështetjes për sektorin rezidencial si konsumuesit kryesor të energjisë. Njëkohësisht, fushatat e vetëdijësuese duhet të vazhdojnë për të nxitur kursim të përgjithshëm të energjisë, përmes rritjes së ndërgjegjësimit.

Shtojca

Tabela 1. Progresi në realizimin e objektivave kyçe të Strategjisë së Energjisë 2022 - 2031

Objektivat strategjike dhe specifike	Vlera bazë 2021	Caku për vitet 2024/2025	Matjet e fundit 2024/2025	Caku për vitin e fundit 2031
Objektivi 1				
Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjes së sistemit (SAIDI)	80.83 orë/vit	68.9 orë/vit	39.45 orë/vit	51.84 orë/vit
Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve të sistemit (SAIFI)	58.27	49 (2024)	36.53	40.86
Humbjet në shpërndarje	18.48% prej të cilës 15.1% të lejuara dhe 3.38% të palejuara	14.50%	13.7%	9%
Numri i njësive të rinovuara të linjitit	0	TC Kosova A (2024)	0	3 ose 4 njësi të rinovuara
	0	TC Kosova B1 (2025)	0	
	0	TC Kosova B2 (2025)	0	
Objektivi 2				
Reduktimi i emetimit të GS në sektorin e energjisë elektrike krahasuar me 2019	0% [2019]	0% (2024)	6,366 ktCO2 +0.8%	-32%
Pjesëmarrja e burimeve të ripërtritshme në konsumin e sektorit të energjisë elektrike BRE-E	6.30%	Min. 13% (2024)	8% (2025)	Min. 35%
Kapacitetet totale të BRE-ve (përfshi prodhuesit vetë-konsumues)	279 MW	490MW (2025)	330 MW	1,600 MW
Kapaciteti i prodhuesve vetë-konsumues (prosumatorët)	2 MW	30 MW (2025)	34.091 MW	Min. 100 MW
Kapaciteti i instaluar i BRE-ve në sistemet e ngrohjes qendrore	15 MWth	Min. 65 MWth (2025)	15MWth dhe 1.2 elektrik	Të përcaktohet nga studimi i fizibilitetit
Objektivi 3				
Niveli i konsumit final të energjisë	1,516 ktoe (2017)	1,709 ktoe (2024)	1,472.72 ktoe (2024)	1,877 ktoe
Kursimet kumulative të energjisë në ndërtesa publike	2.6 ktoe	3.3 ktoe (2024)	21.79 ktoe (2025)	33.9 ktoe
Kursimet totale kumulative të energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe komerciale	0.1 ktoe	14.46 ktoe (2024)	14.22 ktoe (2024)	232.5 ktoe
Numri i ndërtesave me konsum të energjisë afër zero	0	10 (2024)	0	150
Kursimet kumulative të energjisë të arritura në sektorin e ndërtimit	2.7 ktoe	17.79 ktoe (2024)	36.01 ktoe	266.4 ktoe

Objektivat strategjike dhe specifike	Vlera bazë 2021	Caku për vitet 2024/2025	Matjet e fundit 2024/2025	Caku për vitin e fundit 2031
Rritja e kapacitetit të kogjenerimit në Termokos (Prishtinë)	140 MWth	140 MWth (2024)	140MWth	280 MWth
Numri i konsumatorëve të lidhur në sistemet e ngrohjes qendrore Prishtinë-Gjakovë	17,791	24,560 (2024)	26,636 gjithsej, 25,752 NQ Termokos, 884 NQ Gjakova	38,240 (Prishtinë dhe Gjakovë). Për komunat tjera do të vendoset në bazë të studimit të fizibilitetit
Objektivi 4				
Kapaciteti i ofruar ndërkufitar/Kapaciteti nominal ndërkufitar	Eksporti: 22-24%, Importi: 24-26%	Secili drejtim min. 28-30%	Eksporti: 22-24%, Importi: 24-26%	Secili drejtim 70%
Numri i të diplomuarve të rinj në vit që marrin diplomë akademike ose kualifikim profesional në programe të reja në fushën e energjisë dhe fushat e ndërlidhura	/	Të përcaktohet	127 në arsim profesional (16 vajza) KEDS Academy: (215) FIM: 14 FIEK: 28	Të përcaktohet
Përqindja e grave të punësuar në sektorin e energjisë	9%	11%	20%	Min. 25%
Objektivi 5				
Numri i skemave të reja dedikuara konsumatorëve në nevojë	/	2 (2024)	3	4
Numri i programeve që mbështesin projektet e komuniteteve të energjisë në eficiencë dhe vetëkonsum	1	>2	1	>5
Skema për mbështetjen e çmimeve për konsumatorët në nevojë	Skema mbështetëse ekzistuese (e pashënjestruar si duhet)	Themelimi i programit të ri për konsumatorët në nevojë (2024)	1	Skemë bazuar në testin e varfërisë, e lidhur me skemën e reformuar të asistencës sociale
Zbatimi i fushatave vetëdijësuese dhe informuese për energjinë	6	9 çdo vit	17 (2024)	9 çdo vit

Objektivat strategjike dhe specifike	Vlera bazë 2021	Caku për vitet 2024/2025	Matjet e fundit 2024/2025	Caku për vitin e fundit 2031
Emetimet e pluhurit, NOx dhe SO ₂ të termocentraleve të linjtit	TC Kosova B: Pluhuri: mbi 300 mg/Nm³ NOx: mbi 500 mg/Nm³ SO₂: mbi 600 mg/Nm³ TC Kosova A: Pluhuri: mbi 50 mg/Nm³ NOx: mbi 600 mg/Nm³ SO₂: mbi 600 mg/Nm³	TC Kosova B1: Pluhuri: mbi 300 mg/Nm³, NOx: mbi 500 mg/Nm³ SO₂: mbi 600 mg/Nm³. TC Kosova B2: Pluhuri: 20 mg/Nm³ NOx: 200 mg/Nm³ SO₂: 600 mg/Nm³. TC Kosova A3: Pluhuri: 20 mg/Nm³ NOx: mbi 200 mg/Nm³ SO₂: 200 mg/Nm³ TC Kosova A4 & A5: Pluhuri: mbi 50 mg/Nm³, NOx: mbi 600 mg/Nm³ SO₂: 600 mg/Nm³	Termocentrali “Kosova A” Blloku A3: Pluhuri 58.8 mg/ Nm³ SO₂: 503.75 mg/ Nm³ NOx: 671.66 mg/ Nm³ Blloku A4: Pluhuri 59.2 mg/ Nm³ SO₂: 548.64 mg/ Nm³ NOx: 677.33 mg/ Nm³ Blloku A5: Pluhuri 59.4 mg/ Nm³ SO₂: 533.75 mg/ Nm³ NOx: 687.73 mg/ Nm³ Termocentrali “Kosova B” Blloku B1 : Pluhuri 388 mg/ Nm³ SO₂: 305 mg/ Nm³ NOx: 565 mg/ Nm³ Blloku B2 : Pluhuri 410 mg/ Nm³ SO₂: 445 mg/ Nm³ NOx: 593 mg/ Nm³	TC Kosova B: Pluhuri: 20 mg/Nm³ NOx: 200 mg/Nm³ SO₂: 200 mg/Nm³. TC Kosova A: Pluhuri: 20 mg/Nm³, NOx: 200 mg/Nm³ SO₂: 200 mg/Nm³

Burimi: Ministria e Ekonomisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE)

